



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 207 Akti**

**Nr. 267. Vendimi**

**Tiranë, më 24.6.2020**

**V E N D I M**

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Xhensila Pine</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në datën 18.6.2020, ora 10:10, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ridvan Hado**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Ridvan Hado, në seancën dëgjimore si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

1. Z. Ridvan Hado është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Z. Ridvan Hado, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.11.2018, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Xhensila Pine (relatore).
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit

të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues, i shortuar pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin qarkullues<sup>1</sup> nr. 2, në datën 27.4.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Ridvan Hado, bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për të sjellë prova e shpjegime për të provuar të kundërtën, deri në datën 10.6.2020, afat i cili u vendos në zbatim të Aktit Normativ nr. 21, miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 27.5.2020, publikuar në Fletoren Zyrtare, për disa ndryshime në Aktin Normativ nr. 9, datë 25.3.2020, "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19".

7. Në datën 10.6.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, depozitoi shpjegimet dhe provat të cilat u administruan dhe analizuan nga trupi gjykues.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 11.6.2020, vendosi riçeljen e hetimit për verifikimin e disa akteve lidhur me kriterin profesional. Për këtë arsye, subjekti u njoftua nëpërmjet postës elektronike<sup>2</sup>, duke i bere me dije të drejtën të njihet me dokumentacionin dhe paraqesë shpjegime deri në ditën e seancës gjyqësore.

9. Në datën 15.6.2020, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimin shtesë lidhur me kriterin e vlerësimit profesional dhe të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Ridvan Hado, në seancë dëgjimore, për t'u mbajtur në datën 18.6.2020, ora 10:10, në Pallatin e Koncerteve Tiranë, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke respektuar masat mbrojtëse nga COVID-19.

## **I. SEANCA DËGJIMORE**

10. Në datën 18.6.2020, ora 10:10, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, z. Ridvan Hado edhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

10.1 Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës

<sup>1</sup> Vendimi është marrë në mënyrë qarkulluese për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, dhe masave të ndërmarra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në drejtim të kufizimit të veprimtarisë në zbatim të vendimin nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave.

<sup>2</sup> Subjekti u njoftua nëpërmjet postës elektronike se është riçelur hetimi për verifikimin e votës së tij në mbledhjen e KLD-së, të zhvilluar në datën 10.2.2017 për shqyrtimin e propozimit të ish-ministrit të Drejtësisë për shkarkimin e gjyqtarit P. A.

18.6.2020 u ndërpre për të vazhduar në datën 24.6.2020 me shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

## **II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

11. Subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI**

### **A.VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

12. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit (LDKPKI) ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ridvan Hado. Në përfundim të veprimeve verifikuese ILDKPKI-ja bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84.2016 ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

#### **A/2 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

13. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016: për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; për verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton se:

#### **Në deklaratën “Vetting”, z. Ridvan Hado, ka deklaruar:**

14. **Apartament banimi** me sip. 146 m<sup>2</sup>, ndodhur në Blv. “Zh.D.’A”, h. \*\*, ap. \*\*\*regjistruar në AKSH-në Tiranë në z. k. \*\*\*, nr. \*\*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*. Vlera: 8.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Burimi krijimit: kredi nga Banka e Shqipërisë.

15. Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 me përshkrimin “kontratë sipërmarrjeje, datë 10.6.2004 për blerje apartamenti me adresë Blv. “Zh. D’A”, kulla \*\*, në emër të bashkëshortes”. Vlera: 8.000.000 lekë. Pjesa takuese: ½.

16. Në datën 10.6.2004, bashkëshortja e subjektit porosi me kontratë sipërmarrje të lidhur me shoqërinë “M. K” sh.p.k., me nr.\*\*\*rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.6.2004, apartament banimi me sip 146 m<sup>2</sup>, në adresën: Blv. “Zh. D. A”, kulla \*\*, k. \*\*, \*\*, orientimi lulishte, Tiranë.

17. Në datën 29.7.2014, bashkëshortja e subjektit nënshkruan me shoqërinë “M. K” sh.p.k., kontratën e shitblerjes së apartamentit me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., për blerjen e apartamentit

me sip. 146 m<sup>2</sup>, kati \*\*<sup>3</sup>, kulla \*\*, regjistruar në AKSH-në Tiranë në z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, me adresë: Blv. “Zh. D’A”, Tiranë.

18. Nga AKSH-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019, konfirmohet regjistrimi i apartamentit në datën 2.9.2014 në pronësi të bashkëshortes së subjektit, znj. B.H.

19. Referuar kontratave, u evidentua se apartamenti apartamenti,përshkruhej në katin \*\* dhe në katin \*\*, dhe nga administrimi i akteve të hetimit administrativ nuk u konstatua lidhja e ndonjë marrëveshje midis shoqërisë sipërmarrëse dhe bashkëshortes së subjektit, me qëllim ndryshimin e kushteve kontraktuale me objekt ndërrimin e apartamentit, mbi të cilin do të kalohej pronësia. Për këtë konstatim subjektit iu kërkua të japë sqarime<sup>4</sup> i cili shprehet se:

*“Pavarësisht se në kontratën e sipërmarrjes është pasqyruar kati i \*\*, ndërsa në kontratën e shitblerjes kati i \*\*, bëhet fjalë për të njëjtin apartament (vetëm një apartament) të pandryshuar nga momenti i porositjes e deri më sot. Adresa ku ndodhet apartamenti ka ndryshuar përfundimisht pas kolaudimit nga bashkia, si dhe numërtimit të dyqaneve duke u bërë, kulla nr. \*\*, kati \*\*, apartamenti \*\*, Tiranë”.*

#### **a) Lidhur me deklarinin ndër vite të kësaj pasurie**

20. Komisioni verifikoi deklaratat periodike vjetore të subjektit lidhur me deklarinin për këtë pasuri, ku konstatoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar në Deklaraten Periodike Vjetore (në vijim DPV) të vitit 2004 të drejtat reale të lindura nga kontrata sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.6.2004, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive”, i ndryshuar.

20.1 Në DPV-në e vitit 2005, në seksionin e ndryshimeve të shtesave dhe pikësimeve, subjekti ka deklaruar “kontratë sipërmarrjeje, datë 10.6.2004, për blerje apartamenti në adresën: Blv. “Zh. D’A”, kulla \*\*, në emër të bashkëshortes në vlerën 8.000.000 lekë me pjesë takuese ½, ndërsa në seksionin e detyrimeve subjekti ka deklaruar: kredi për banim në vlerën prej 7.600.000 lekësh, sipas aktmarrëveshjes nr. \*\*, datë 23.6.2005.

21. **Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa nuk janë deklaruar në DPV-në e vitit 2004, të drejtat e lindura sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.6.2004, në zbatim të detyrimit për deklarim në deklaratën periodike vjetore, seksioni i ndryshimit të interesave sipas ligjit nr. 9049, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive”, i ndryshuar.**

#### **a/1) Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

22. Subjekti ka shpjeguar se modeklarimi ka ardhur për arsye se nuk ka pasur të drejta reale mbi apartamentin pasi deri në datën 5.6.2014, as shoqëria ndërtuese “M. K” sh.p.k., nuk kishte fituar të drejta reale mbi këtë send. Subjekti ka mbështetur argumentet e tij në dispozitat 193 dhe 195 të Kodit Civil mbi disponimin e të drejtave reale mbi një send të paluajjtshëm nëse janë të regjistruara më parë në regjistrat publikë.

22.1 Ndërkohë, subjekti thekson se në DPV-në e vitit 2005, e ka deklaruar pasurinë, objekt i kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.6.2004, për shkak të kredisë së marrë sipas aktmarrëveshjes së kredisë nr. \*\*, datë 23.6.2005, të lidhur midis Bashkës së Shqipërisë në cilësinë e kredihënësit dhe bashkëshortes së subjektit si kredimarrëse.

<sup>3</sup> Referuar planimetrisë bashkëlidhur kontratës.

<sup>4</sup> Pyetësorin 3 dërguar në datën 5.2.2020 dhe përgjigjet e pyetësorit, datë 11.2.2020, nëpërmjet postës elektronike.

## **b) Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie**

23. Nga hetimi i Komisionit<sup>5</sup> ka rezultuar se shtetasja B.H ka përfituar një kredi pranë Bankës së Shqipërisë, në vlerën 8.000.000 lekë.

24. Kjo kredi është përfituar sipas aktmarrëveshjes nr. \*\*, datës 23.6.2005, midis Bankës së Shqipërisë si kredidhënëse dhe bashkëshortes së subjektit si kredimarrëse në cilësinë e punëmarrësit, të Bankës së Shqipërisë në bazë të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 9.2.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë’”<sup>6</sup>.

25. Sipas informacionit të ardhur nga Banka e Shqipërisë, kredia<sup>7</sup> ka rezultuar e disbursuar në dy pjesë në datë 28.6.2005 vlera 7.600.000 lekë, ndërsa në datë 24.12.2014 vlera 400.000 lekë.

26. Në DPV-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar kredi për banim në vlerën 7.600.000 lekë, dhe në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar disbursim kredie bashkëshortes nga Banka e Shqipërisë në vlerën 400.000 lekë.

27. Shlyerja e kredisë ka filluar në vitin 2007<sup>8</sup>. Subjekti e ka deklaruar shlyerjen e detyrimit sipas kësaj kredie në DPV-në e vitit 2007.

28. Në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.6.2004, është përcaktuar se çmimi në vlerën 8.000.000 lekë, është paguar plotësisht para nënshkrimit të kësaj kontrate.

29. Shoqëria “M. K” sh.p.k., në datën 11.2.2019 informoi se shuma e transaksionit ka qenë në vlerën prej 8.000.000 lekësh paguar, si më poshtë:

- shuma 7.600.000 lekë me transaksion bankar nga kredia bankare në emër të blerëses;
- shuma 400.000 lekë është derdhur në arkën e shoqërisë “M. K” sh.p.k.

30. Shoqërisë sipërmarrëse iu rikërkua<sup>9</sup> informacion mbi kohën e shlyerjes, si dhe dokumentacionin justifikues të pagesave. Shoqëria “M.K” sh.p.k. informoi se për shkak të kohës së largët të kryerjes së transaksioneve nuk e ka ruajtur dokumentacionin shoqërues, por duke iu referuar deklarimeve të palëve në kontratë merr të mirëqenë se vlera e blerjes ka qenë e mbuluar me kredi bankare dhe një pjesë e vogël pranë arkës së shoqërisë.

31. Lidhur me detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë sipërmarrëse në vlerën 400.000 lekë, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit<sup>10</sup> subjekti ka sqaruar se: “Shuma prej 400.000 lekësh është paguar në dhjetor të vitit 2005 në arkën e shoqërisë, por mandatpagesën nuk mundem ta gjej”.

32. Subjekti ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar se burimi i apartamentit ka qenë kredia e marrë në Bankën e Shqipërisë, deklarim i cili nuk përputhet me rezultatin e arrirë nga hetimi administrativ i Komisionit, për sa shuma prej 400.000 lekësh, është *disbursuar* në datën 24.12.2014, dhe nuk mund të jetë përdorur si burim krijimi në vitin 2005.

33. Nga kredia e marrë në vlerën 8.000.000 lekë, vetëm shuma prej 7.600.000 lekësh është përdorur për blerjen e apartamentit, ndërsa shuma prej 400.000 lekësh e paguar në vitin 2005 nuk ka burim kredinë, sikunder ka deklaruar subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar.

34. Komisioni përgatiti analizën financiare për vitin 2005 duke konsideruar vlerën 7.600.000 lek si burim nga kredia, dhe ky vit ka rezultuar me balancë pozitive.

<sup>5</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2019, kthim përgjigjeje të Bankës së Shqipërisë, shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019.

<sup>6</sup> Aktmarrëveshjen në dosjen e ILDKPKI-së aneksi 4/8.

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2019.

Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2019.

<sup>9</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2019.

<sup>10</sup> Përgjigje pyetësorit protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020.

**35. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për (i) mospërputhjet lidhur me deklarin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit kalimtar në raport me rezultatin e arrirë nga hetimi administrativ i Komisionit, (ii) faktit se vetëm shuma prej 7.600.000 lekësh nga kredia e marrë në vlerën 8.000.000 lekë ishte përdorur për blerjen e apartamentit.**

**b/1) Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

36. Mbi barrën e provës së kaluar, lidhur me mospërputhjen në deklarin të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit kalimtar në raport me rezultatin e arrirë nga hetimi administrativ i Komisionit, lidhur me burimin e përdorur për blerjen e pasurisë kredi bankare në shumën 8.000.000 lekë, subjekti e ka konsideruar të drejtë rezultatin e Komisionit duke sqaruar se *“Në DPV të vitit 2005 nuk kam deklaruar kursime nga paga ime dhe e bashkëshortes, duke qenë se është përdorur një shumë prej 400.000 lekësh për pagimin e pjesës tjetër të pa disbursuar nga Banka e Shqipërisë. Nga analiza financiare e bërë nga KPK-ja me të drejtë është arritur në përfundimin se: “Nga analiza financiare duket se subjekti ka patur mundësi financiare të investojë në blerjen e kësaj pasurie si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.”. Pra, përse kohë unë kam pasur mundësi financiare nuk kam pasur asnjë arsye për të bërë deklarin të pasaktë“.*

**c) Lidhur me mënyrën e pagimit të çmimit të blerjes**

37. Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin justifikues për kryerjen e pagesave për blerjen e apartamentit, i cili në përgjigje të pyetësorit<sup>11</sup> të dërguar ka depozituar kopje të urdhër pagesës së brendshme, datë 23.7.2005, lëshuar nga “P.C. B” për lëvrimin e vlerës prej 7.600.000 lekësh, me përfitues shtetasin A.L.

38. Kredia në vlerën 7.600.000 lekë disbursuar në datën 28.6.2005 në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në “P.C. B”, në datën 23.7.2005<sup>12</sup> është transferuar në llogari të shtetasit A.L, me përshkrimin “apartamenti Blv. Zh.D’A”. Kredia ka kaluar në llogarinë personale të shtetasit A.L, i cili në kohën e kryerjes së këtij transaksioni nuk ishte administrator i shoqërisë “M.K” sh.p.k., sepse ishte larguar me vendimin e datës 12.7.2005 të asamblesë së ortakëve, sipas vendimit nr. \*\*\*të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë depozituar në QKB, më 20.7.2005.

**39. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime përse shuma prej 7.600.000 lekësh e marrë kredi nga Banka e Shqipërisë për blerjen e apartamentit, nuk kishte kaluar në llogarinë e shoqërisë sipërmarrëse “M. K” sh.p.k., por kishte kaluar në llogarinë e shtetasin A.L.**

**c/1) Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës**

40. Mbi barrën e provës së kaluar, në lidhje me pagimin e çmimit në llogari të shtetasit A.L subjekti sqaroi se: *“Duke qenë se bashkëshortja ime znj. B.H në këtë shoqëri e njëhte shtetasin A.L si administrator<sup>13</sup> dhe ortak të shoqërisë nga komunikimi me këtë të fundit në respektim të kontratës së sipërmarrjes ka bërë transfertën bankare në shumën 7.600.000 lekë në datën 23.7.2005 pas disbursimit të kredisë.”* Ai pretendoi se bashkëshortja e tij ka qenë në kushtet e mirëbesimit sipas nenit 467 të Kodit Civil, pasi rrethanat faktike, largimi i administratorit dhe

<sup>11</sup> Dokumentacioni bashkëlidhur pyetësorit protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020.

<sup>12</sup> Komunikimi elektronik i mbajtur me “P.C. B”, datë 18.12.2019.

<sup>13</sup> Kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar prej shtetasit A.L.

kryerja e pagesës në shumën 7.600.000 lekë, nëpërmjet transfertës bankare, kanë ndodhur brenda një afati kohor disa ditore

#### **d) Lidhur me sigurimin e kredisë marrë Bankës së Shqipërisë**

41. Për të siguruar përmbushjen e detyrimit në vlerën 8.000.000 lekë, ka rezultuar se<sup>14</sup> në datën 23.6.2005 është lidhur kontrata e hipotekimit me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., midis shoqërisë “M.K” sh.p.k., në cilësinë e hipotekuesit, dhe bashkëshortes së subjektit në cilësinë e kredimarrëses, dhe Bankës së Shqipërisë në cilësinë e përfituesit, me objekt vënien hipotekë të gjashtë pasurive, lloji garazh në pronësi të shoqërisë “M.K” sh.p.k.

42. Në datën 17.11.2014 është bërë zëvendësimi i hipotekës së mësipërme me hipotekimin e apartamentit të banimit deri në shlyerjen e plotë të detyrimit të kredisë së marrë në Bankën e Shqipërisë, sipas kontratës së hipotekimit nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., midis bashkëshortes së subjektit dhe Bankës së Shqipërisë<sup>15</sup>.

43. Komisioni ka hetuar nëse subjekti është gjendur në situatat e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së tij me shoqërinë ndërtuese, apo përfaqësuesit ligjorë/ortakët e shoqërisë, në përfundim të të cilit nuk ka rezultuar që subjekti të ketë shqyrtuar çështje gjyqësore dhe, për rrjedhojë, të ketë qenë në kushte konflikti për shkak të ushtrimit të funksionit si gjyqtar me asnjë nga përfaqësuesit ligjorë/ortakë personalisht apo me shoqërinë.

44. Subjektit iu kërkua të paraqiste shpjegime për sa duket se ka patur një marrëdhënie interesi midis subjektit|bashkëshortes së subjektit dhe shoqërisë M.K për sa shoqëria ka pranuar të vërë në rrezik potencial interesat e saj pasurorë nëpërmjet bllokimit të gjashtë pasurive të saj për një periudhë prej nëntë vitesh me qëllimin e vetëm sigurimin e kredisë së marrë nga bashkëshortja e subjektit, duke vlerësuar se në kushtet kur këto pasuri nëse nuk do të viheshin hipotekë do të ishin të lira në qarkullimin civil e për rrjedhojë shoqëria e ndërtimit përfitonte të ardhura potencialisht nga këto pasuri.

45. Subjekti ka shpjeguar se nga hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me konfliktin e interesit nuk kanë rezultuar kushte konflikti me asnjë nga përfaqësuesit ligjor|ortak të shoqërisë, për shkak të ushtrimit të funksionit si gjyqtar . Gjithashtu, Shoqëria “M.K” sh.p.k nuk i ka bërë subjektit apo bashkëshortes “trajtim preferencial”<sup>16</sup> në asnjë drejtim pasi marrëdhënia ka qenë me shpërblim dhe në këtë marrëdhënie ka hyrë bashkëshortja e tij e cila nuk ka pasur cilësinë e gjyqtarit. Nga ana tjetër bllokimi i pasurive është bërë nga shoqëria “M. K” sh.p.k pasi ishte në interesin e saj që të paguhej nëpërmjet levrimit të kredisë çmimi i blerjes së apartamentit.

#### **e) Lidhur me çmimin e blerjes të apartamentit**

46. Komisioni gjithashtu verifikoi çmimet referencë për tregun e lirë të shitblerjeve sipas informacionit të Entit Kombëtar të Banesave, nga ku rezultoi se në vitin 2004 kostot e shitjes për sipërfaqe të shfrytëzueshme në Tiranë kanë qenë 68.571 lekë/m<sup>2</sup> dhe, për rrjedhojë, apartamenti me sip. 146 m<sup>2</sup> i blerë nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2004 ka pasur vlerën prej 10.011.366 lekë. Pra, apartamenti ishte blerë më lirë krahasuar me çmimet e shitblerjes së apartamenteve në tregun e lirë për vitin 2004 në Tiranë.

<sup>14</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2020.

<sup>15</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019.

<sup>16</sup>Neni 2 pika 10 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003, “Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, nën titullin “Përkufizime”, ku thuhet shprehimisht se: “Përveçse kur përcaktohet ndryshe, në ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:... 10. “Trajtime preferenciale” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, asetet, shërbimet, mallrat ose përfitime të tjera të ngjashme që i jepen ose janë në përdorim nga personi, pa shpërblim, si pasojë e detyrës, marrëveshjeve ose kontratave

47. Mbi konstatimin e Komisionit, subjektit sqaroi se: *“Çmimi i blerjes së apartamentit në Bulevardin “Zh. D’A” është negociuar nga unë dhe bashkëshortja ime me firmën ndërtuese. Apartamenti është me orientim nga veriu dhe kaq ka qenë çmimi në atë kohë”*.

47.1 Subjekti, për të provuar shpjegimet, solli në cilësinë e provës, vërtetim datë 21.11.2019 lëshuar nga shoqëria ndërtuese “M. K” sh.p.k., sipas së cilit konfirmohet vlera e apartamentit, si dhe dy kontrata shitblerjeje: nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.11.2014; dhe nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.7.2014, të lidhura midis shoqërisë dhe shtetasve të tjerë, për të provuar çmimet e shitblerjes të aplikuara nga shoqëria në vitin 2014, kur është blerë pasuria.

#### **Qendrimi i Komisionit**

48. Trupi gjykues, pasi analizoi provat nga hetimi administrativ, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton se:

49. Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë duke deklaruar kredinë në shumën 8.000.000 lekë, nga hetimi rezultoi se vetëm shuma prej 7.600.000 lekësh ishte burim nga kredia, ndërsa shuma prej 400.000 lekësh nuk mund të kishte burim këtë kredi.

50. Subjekti nuk ka deklaruar saktë burimet e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 9049, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së “Mbi mënyrën e deklaramit të pasurive në pronësi, posedim, përdorim në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, duke mos deklaruar burimin nga të ardhurat për vlerën 400.000 lekë.

51. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti nuk ka deklaruar saktë burimin e kësaj pasurie në vetting, por ky mosdeklaram nuk ndikon në analizën financiare të këtij viti.

52. Në lidhje me mosdeklaramin e kësaj pasurie, në deklaratën periodike të vitit 2004, trupi gjykues vlerëson se subjekti duhej të kishte deklaruar gjendjen faktike në lidhje me kontratën e sipërmarrjes, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar çdo akt që prodhonte apo përfaqësonte të dhëna në lidhje me të drejtat reale për këtë pasuri.

53. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti nuk ka pasqyruar saktë në DPV-në e vitit 2004 të drejtat e lindura sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.6.2004,

54. Lidhur me çmimin e apartamentit dhe shlyerjen e tij, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti arriti të shpjegojë se bashkëshortja ka qenë në kushtet e mirëbesimit sipas nenit 467 të Kodit Civil,<sup>17</sup> pasi rrethanat faktike, të krijojnë bindjen se bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur mundësinë efektive të dijë se shtetasi A.L nuk ishte më përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “M.K” sh.p.k. Subjekti arriti të provojë se nuk ka përfutuar çmim preferencial prej shoqërisë si dhe nuk ndodhej ne kushtet e konfliktit të interesit.

55. Trupi gjykues vlerëson të nënvizojë se në vlerësim të të gjitha rrethanave, konkluzionet e mesiperme, për pasaktësia në deklaramin e burimit nuk çon subjektin në deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. 0

**56. Lidhur me 1/4 e sipërfaqes së tokës** prej 674 m<sup>2</sup>, parcela nr. \*\*\* , ndodhur në Rr. “M. Gj”, kthyer 421 m<sup>2</sup> dhe 56 m<sup>2</sup> me të drejtë parablerje me vendimin nr. \*\*\* datë 23.10.1995. Pjesa

<sup>17</sup>Në 467 të këtij kodi nën titullin “Ekzekutimi ndaj një të treti” parashikohet shprehimisht se: *“Debitori që ekzekuton një detyrim ndaj një personi, i cili sipas rrethanave të padyshimta duket se është i autorizuar ta pranojë atë, shkarkohet nga detyrimi në qoftë se provon se ka qenë në mirëbesim. Personi që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, është i detyruar t’i kthejë kreditorit të vërtetë, atë që ka marrë nga ekzekutimi i detyrimit”*.



takuese: 25 %. Mënyra e fitimit: me trashëgim nga nëna, kthyer me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.10.1995, të K. K. Pronave Tiranë.

57. Me vendimin nr. 282, datë 23.10.1995, i është njohur prona tokë truall të ndjerit Q. D(gjyshit të subjektit), është kthyer dhe kompensuar trashëgimtarëve ligjorë<sup>18</sup>, ndërmjet të cilëve edhe nënës së subjektit, të ndjerës B. Q.D (H) duke u vendosur:

- a. kthim i truallit të lirë me sip. 421 m<sup>2</sup>;
- b. kompensim për truallin e zënë me ndërtime të përhershme me sip. 253 m<sup>2</sup> me një nga mënyrat që përcakton neni 16, i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993;
- c. t'i njohë trashëgimtarëve ligjorë të drejtën e parablerjes së garazheve të parkut me sip. 56 m<sup>2</sup> në bazë të nenit 21, të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993.

58. Në datën 28.1.2009 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë së të ndjerës, nënës së subjektit B.Q.D (H) me vendimin nr. \*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku trashëgimtarë ligjorë rezultojnë: subjekti Ridvan Hado dhe i vëllai R. H, me të drejta nga 1/2 pjesë takuese secili të të gjithë pasurisë trashëgimore.

59. Nga AKSH-ja Tiranë<sup>19</sup>, rezulton se pasuria truall e kthyer me sip. 421 m<sup>2</sup> është regjistruar në z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*\*, në bashkëpronësi të subjektit dhe të trashëgimtarëve të tjerë<sup>20</sup>, sikurse larttrajtuar me ¼ pjesë takuese secili. Gjithashtu është regjistruar e drejta e parablerjes së garazheve të parkut<sup>21</sup> me sip. 56 m<sup>2</sup>.

60. Komisioni, pasi administroi informacionin e marrë nga AKSH-ja Tiranë, lidhur me truallin e kthyer me sip. 421 m<sup>2</sup>, konstatoi se në kartelën e pasurisë, seksioni i kufizimeve, përshkruhej se:

-Në datën 15.12.2016, mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. pas. \*\*\*ND, vol. \*\*, f. \*\*\*\*.

-Në datën 14.7.2017, mbi këtë truall ndodhet ndërtesa \*\*\*ND, vol. \*\*, f. \*\*.

60.1 Gjithashtu, nga hetimi i kryer pranë ATP-së (ish-AKKP-ja) rezultoi e depozituar kartelë pasurie<sup>22</sup> me të njëjtin kufizim sikundër cituar më lart: ndërtesë me nr. pas. \*\*\*ND, vol. \*\*, f. \*\*\*, me sip. totale 86.5 m<sup>2</sup>, me të dhëna pronësie nga subjekti shtet te shtetasi H.M.K, regjistruar me përshkrim të veçantë: shtesë anësore 5 kate në objektin ekzistues 5-katësh, me vol. \*\* f. \*\*, ap. \*\*.Në seksionin e kufizimeve të kësaj pasurie është e shënuar "kjo ndërtesë ndodhet mbi truallin me nr. pas. \*\*\*, vol. \*\* f. \*\*\*, në pronësi të bashkëpronarëve M, H. Kjo ndërtesë nuk ka marrëdhënie me truallin."

61. Gjithashtu, nga administrimi i dokumentacionit të ardhur nga ATP-ja, u konstatua se në vendimin e AKKP-së është përcaktuar se një pjesë e truallit të zënë me ndërtime, prej 253 m<sup>2</sup>, t'i kompensohen subjektit dhe trashëgimtarëve të tjerë ligjorë në një nga mënyrat sipas nenit 16 të ligjit nr. 7698, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", të cilat kanë qenë:

- a. me obligacione shtetërore, që do të përdoren sipas vlerës ekuivalente dhe me përparësi në marrëdhënie me shtetin si në procesin e privatizimit të objekteve shtetërore dhe në veprimtari të tjera që kryhen me kredi;
- b. me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme, por jo më shumë se 5000 m<sup>2</sup>;

<sup>18</sup>B. Q. D (H), B.R. M, F. R. M sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*, datë 31.8.1994.

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019.

<sup>20</sup>B.R.M

F. R. M

R. E.H

R. E.H

<sup>21</sup>Data e lëshimit të certifikatës 21.2.2013 sipas kartelës së pasurisë, datë 4.3.2019.

<sup>22</sup>Kartela është lëshuar në datën 15.6.2017.

c. me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme, por jo më shumë se 5000 m<sup>2</sup>.

62. Nisur nga përcaktimet ligjore, subjektit i është kërkuar të sqarojë nëse ka kompensimin në një nga mënyrat e përcaktuara, si dhe nëse e ka ushtruar të drejtën e parablerjes mbi garazhet e parkut, sipas vendimit të AKKP-së.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

63. Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Me vendimin nr. 282, datë 23.10.1995, nga ana e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, mua dhe të afërmve të mi na është njohur tokë truall me sip. 674 m<sup>2</sup>, duke na kthyer fizikisht sipërfaqen tokë truall 421 m<sup>2</sup>. Na ka njohur të drejtën e kompensimit për sipërfaqen e zënë me ndërtime prej 253 m<sup>2</sup> dhe të drejtën e parablerjes të garazheve të parkut me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> që janë të ndërtuar mbi truallin tonë. Në lidhje me të drejtën e parablerjes së garazheve me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> sqaroj se nuk e kam ushtruar këtë të drejtë deri më sot pasi nuk kam paraqitur kërkesë pranë Ministrisë së Ekonomisë për privatizimin e tyre. Gjithashtu nuk jemi kompensuar në asnjë nga mënyrat e parashikuara nga ligji për sipërfaqen tjetër të zënë me ndërtime. Për sa kohë që unë nuk kam ushtruar të drejtën e parablerjes prezumoj që pronësia e këtyre objekteve është ende e pronarit shtet”. Për të provuar shpjegimet, subjekti ka sjellë në cilësinë e provës dokumentet: vendim nr. \*\*\* datë 23.10.1995, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 1.3.2011; kartela e pasurisë së paluajtshme dhe harta treguese e regjistrimit, si dhe akte që u administruan nga Komisioni.*

64. Komisioni ka pyetur sërish subjektin e rivlerësimit për të dhënë shpjegime mbi sipërfaqen e kthyer prej 421 m<sup>2</sup>, nëse trualli është i lirë apo i zënë. Në përgjigje të pyetësorit<sup>23</sup> subjekti ka sqaruar se: *“Mund të them se sipërfaqja e kthyer prej 421 m<sup>2</sup> me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.5.1995, të ish-Kthimit të Pronave nga pikëpamja faktike ka rezultuar e zënë me ndërtime pa leje (shtesa pallatesh), si dhe një vendstrehim që para viteve 1990”. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: përgjigjen e datës 22.11.2019 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Jug bashkë me dokumentacionin e depozituar në dosje lidhur me këtë pasuri, si dhe foto të sipërfaqes së kthyer me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.5.1995, të ish-KKK Pronave (4 foto), sipas së cilës rezulton se mbi pronën e sipërcituar janë bërë dy legalizime pronash.*

65. Komisioni administroi shkresën dhe dokumentacionin bashkëlidhur, sipas së cilës ASHK-ja Tiranë sqaron se lidhur me të drejtat e parablerjes mbi garazhet nuk rezultojnë të pasqyruara as në kartelat e pasurisë, as në hartat treguese. Ndërsa, lidhur me ndërtesat e ndodhura mbi truall, ASHK sqaron se ndërtesa me nr. pasurie \*\*\* ND, vol. \*\* f. \*\*\*, në pronësi të shtetasit H.K, është përfutur me leje legalizimi. Ndërsa pasuria me nr. \*\*\* ND, vol. \*\*, f. \*\*, është në bashkëpronësi të shtetasit I.B dhe shtetit, e përfutur me leje legalizimi.

66. Trupi gjykues, pasi analizoi në tërësi provat nga hetimi administrativ, deklarin, shpjegimet dhe provat që paraqiti subjekti gjatë hetimit administrativ, si dhe shqyrtoi legjislacionin në fuqi në kohën e njohjes së të drejtës së pronësisë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të drejtat reale mbi këtë pasuri, dhe mosushtimin e tyre për shkak të kufizimeve ligjore. Gjithashtu nuk u provua që subjekti të kishte përfutur në një nga mënyrat e kompensimit ligjor, për shkak të zënies së tokës truall me objekte ndërtuese.

67. **Lidhur me automjetin tip “V.G”, viti i prodhimit 1993, me targa TR 3196 K, blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 15.6.2010. Vlera: 2.600 euro. Pjesa takuese: 50 %. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DPV-në e vitit 2010.**

<sup>23</sup>Përgjigje pyetësorit protokolluar në Komision me nr. \*\*\*\* prot., datë 11.2.2020.

68. Nga hetimi i Komisionit<sup>24</sup> rezultoi se në emër të subjektit është regjistruar pronësia mbi automjetin tip “V. G”, me targa TR \*\*\* K, e fituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 15.6.2010, kundrejt çmimit 2.600 euro.

69. Komisioni përgatiti analizën financiare nga ku rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në blerjen e pasurisë së luajtshme automjet në vitin 2010.

#### 70. Lidhur me Llogari bankare të bashkëshortes

Llogari bankare Iban. \*\*\*\*\*, në “U.B”. Vlera: 919.450.4 lekë. Pjesa takuese: 100 %. dhe Llogari bankare Iban. \*\*\*\*\* në “U. B”. Vlera: 175.213.02 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Ilogari bankare Iban. \*\*\*\*\*, në “P.C. B”. Vlera: 440.884.04 lekë.

71. Nga hetimi<sup>25</sup> deklarimi i subjektit përputhet me informacionin nga Bankat.

72. Lidhur me Llogari depozite bankare Iban. \*\*\*\*\* në “R.B” krijuar nga kursimet familjare. Vlera: 2.402.830.07 lekë.50 %.

73. Komisioni hetoi<sup>26</sup> në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite hapur në datën 27.3.2015, në shumën 2.400.000 lekë.

74. Në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003, subjekti ka deklaruar bono thesari në vlerën 1.500.000 lekë në Bankën e Shqipërisë me burim nga kursimet e përbashkëta me bashkëshorten.

74.1 Vlera e tërhequr në datën 23.7.2004 nuk rezulton e deklaruar në DPV-në e vitit 2004, në formën e gjendjes *cash*. Ajo nuk është marrë në konsideratë në analizë financiare.

75. Pa marrë në konsideratë gjendjen *cash* të padeklaruar në vitin 2004 rezulton se në fund të vitit 2014, subjekti ka pasur 2.250.000 lekësh gjendje *cash*, referuar deklarimeve periodike.

75.1 Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti nuk deklaron pakësim të gjendjes *cash* për krijimin e kësaj depozite, por vetëm pakësim të *cash-it* në vlerën 200.000 lekë.

76. Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2015.

Nr.	Analiza financiare e vitit 2015	2015
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,631,158</b>
	Të ardhura nga paga subjekti	1,293,938
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	1,337,220
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,452,772</b>
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	897,104
	Shpenzime shkollimi (djali) shkolla “Y”	75,000
	Shpenzime për pushime	125,000
	Shpenzime TIMS	64,007
	Kredi	291,661
<b>3</b>	<b>PASURI</b>	<b>1,759,516</b>
	<b>Pasuri e paluajtshme/e luajtshme</b>	
	<i>Ndryshim/Likuiditeti</i>	1,759,516
	<b>DIFERENCA (1-2-3)</b>	<b>-581,130</b>

<sup>24</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

<sup>25</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2019, të “U. B.”.

<sup>26</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2019, të “R.B”.

77. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën, për pamundësi financiare në shumën -581.130 lekë, për vitin 2015.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

78. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, lidhur me pasaktësitë në deklaratat periodike për sa i përket pakësimit të gjendjes *cash*, ka shpjeguar se:

*“Është e kuptueshme dhe e përcaktueshme që kjo gjendje cash është pakësuar, përderisa në DPV-në e vitit 2015 është deklaruar si burim krijimi 'kursime familjare' dhe janë përdorur pikërisht vetëm ato që kanë qenë jashtë sistemit bankar.*

*Shuma prej 1.500.000 lekësh (bono thesari) e tërhequr në datën 23.7.2004 e kam mbajtur cash në shtëpi. Nga ana ime duke qenë se ishin vitet e para të deklarimit nga pakujdesia dhe faktit që unë këtë shumë e kam tërhequr nga banka dhe nuk e kisha përdorur nuk e kam deklaruar si kursim cash në shtëpi duke prezumuar se për sa kohë e tërhoqa nga banka dhe nuk e shpenzoza dhe banka është lehtësisht e verifikueshme nënkuptohet që e kisha kursim në shtëpi.”*

#### **Analiza e fakteve dhe e ligjit të zbatueshëm**

79. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për shtimin e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar në vitin 2004 dhe pikësimin e kursimeve *cash* në vitin 2015 është i pambështetur në prova dhe në ligj.

80. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-2004 si shtesë të kursimeve cash shumë prej 1.500.000 lekë të tërhequr nga banka në datën 23.07.2004,

80.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-2015 pakesimin e gjendjes *cash* për krijimin e depozitës prej 2.400.000 lekë.

81. Trupi gjykues vlerëson se legjislacioni në fuqi që përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave private ka qenë i qartë në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit.

82. Mënyra e deklarimit periodik ka mbetur e pandryshuar, pavarësisht ndryshimeve që mund të kenë pësuar, ndër vite, ligjet e zbatueshme, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk ka qenë asnjëherë në kushtet e paqartësisë ligjore në drejtim të detyrimit për deklarim sipas legjislacionit në fuqi.

83. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet në formën e gjendjes *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

84. Trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 9043/2003, i ndryshuar, ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë dhe pakësim të pasurisë në çdo formë që ndodh përgjatë një viti periodik.

85. Trupi gjykues vlerëson se shtimi i kursimeve në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar dhe pakësimi i tyre duhet të merren sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike/vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

86. Trupi gjykues arrin në përfundimin se analiza financiare për vitin 2015 mbetet e pandryshueshme, dhe subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

87. Për vitin 2015 me të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka rezultuar me një bilanc negativ prej -581.130 lekësh.

88. Trupi gjykues vlerëson se mungesa e likuiditeteve gjatë vitit 2015, në vlerën -581,130 lekësh, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

89. Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2003 – 2016, nga ku në përfundim rezultoi negativ vetëm viti 2015, ndërsa vitet e tjera rezultuan me një balancë pozitive.

### **ÇËSHTJE TË TJERA**

90. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, u konstatua se me vendimin nr. 93 datë 25.1.1995, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, AKKP-ja i ka njohur trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit H.R.H të drejtën e pronësisë mbi një sipërfaqe trualli prej 2500 m<sup>2</sup> të ndodhur në qytetin e Delvinës, si dhe kompensimin me obligacione shtetërore për sipërfaqen e truallit të zënë prej 2500 m<sup>2</sup>. Sipas këtij vendimi subjekti i rivlerësimit bashkë me nënën e tij, të ndjerën B. H, kanë përfituar 1/6 dhe 1/24 pjesë si trashëgimtarë të tij të radhës së parë të të ndjerit E. H.

91. Subjekti nuk i kishte deklaruar këto drejta të përfituara në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, si dhe në deklaratën para fillimit të detyrës, në zbatim të detyrimit për deklarimin sipas ligjit nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”, i ndryshuar, dhe në këto kushte subjektit i kaloi e drejta për të dhënë shpjegime lidhur me konstatimin e Komisionit

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

*“Deklaroj me përgjegjësi të plotë se nuk kam pasur dijeni për ekzistencën e vendimi nr. \*\*, datë 25.1.1995, ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronave’ të K.K. Pronave ish-Pronarëve Bashkia Delvinë. Sikurse rezulton që nga aktet që ka administruar KPK-ja lidhur me këtë vendim, unë së bashkë me nënën time të ndjerën B. H kemi lëshuar vetëm një prokurë në datën 8.3.1993, pra 27 vite më parë ku kemi autorizuar shtetasin T. H, i cili është xhaxhai tim, për të ndjekur çështjen e kthimit të pronave që ndodhen në qytetin e Delvinë që mund të fitonte babai tim, i ndjeri E. H, si trashëgimtar ligjor i babait të vet (gjyshi im) R. H. Pas lëshimit të këtij akti unë nuk jam interesuar lidhur me këtë pronë dhe nuk e kam ditur se çfarë është bërë. Në rastin konkret është njohur një pronë e vitit 1947 dhe titulli i kësaj prone janë pikërisht aktet e pronësisë së vitit 1947, ku unë nuk kisha lindur ende.”*

Trupi gjykues vlerëson se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm padijeninë e tij për të drejtat reale për pasurinë truall në qytetin e Delvinës sipas vendimit të AKKP-së.

#### **Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë**

92. Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatores të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat e paraqitura prej tij arrin në përfundimin se 92.1 Mungesa e likuiditeteve në vitin 2015, në vlerën prej – **581.130** lekësh, si dhe pasaktësia e deklarimit të burimit nuk janë në masën që të përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi nuk kanë ndikuar në drejtimit të deklarimit të pasurive në përputhje me detyrimet ligjore, që subjekti i rivlerësimit ka pasur. Subjekti i rivlerësimit, Z. Ridvan Hado, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

Analiza financiare 2003 – 2016

Nr	Pershkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	<b>TE ARDHURA</b>	1,177,259	1,317,113	1,293,841	1,781,687	1,958,161	2,099,752	2,734,029	3,160,644	2,386,194	2,403,655	2,752,352	2,753,283	2,631,158	2,975,647
	Të ardhura nga paga Subjekti	605,088	760,361	773,592	798,260	826,617	838,062	966,460	967,337	976,761	1,012,972	1,098,854	1,297,709	1,283,938	1,401,448
	Të ardhura nga paga Bashkëshortja	572,171	556,752	520,249	983,427	1,131,544	1,261,690	1,317,569	1,418,207	1,409,433	1,390,683	1,428,348	1,301,824	1,337,220	1,574,199
	Të ardhura dëmshpërblim nga të përndjekurit politikë (babai)	-	-	-	-	-	-	-	225,100	-	-	225,150	-	-	-
	Të ardhura dëmshpërblim nga të përndjekurit politikë (daja)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	153,750	-	-
	Të ardhura nga shija e ap. në Elbasan 1/2	-	-	-	-	-	-	450,000	550,000	-	-	-	-	-	-
2	<b>SHPENZIME</b>	521,592	521,592	(6,781,334)	438,228	682,908	819,341	883,844	1,319,341	581,996	1,299,032	1,029,518	1,442,598	1,452,772	1,397,432
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	281,592	281,592	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
	Shpenzime qiraje	240,000	240,000	140,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Shpenzime shkolli (djal) Shkolla Y.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	72,000	75,000	76,000
	Shpenzime shkolli (vajza) Shkolla Y.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	76,000
	Shpenzime plazhi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	125,000	-
	Shpenzime TIMS	-	-	40,438	-	-	-	64,504	-	12,655	162,075	92,562	17,745	64,007	51,403
	Shpenzime a treditimi	-	-	200,000	-	-	-	-	-	200,000	300,000	100,000	200,000	-	-
	Shpenzime të tjera kredia 400.000 lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	400,000	-	-
	Kredi: 23.06.2005 (7.600.000)+ 24.12.2014 (400.000)	-	-	(7.600.000)	-	136,428	272,861	272,861	272,861	272,861	272,861	272,861	(127,139)	291,661	291,661
	Dhënie borxhi: Atlet Bodeci (03.11.2010)	-	-	-	-	-	-	-	500,000	(450,000)	-	-	-	-	-
	Detyrim ndaj shkollës Y.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	(88,000)
	Detyrim ndaj shkollës Y.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	<b>PASURI</b>	400,000	(1,495,749)	7,923,827	836,853	550,675	739,553	961,725	85,876	329,666	(290,006)	637,108	597,324	1,759,516	251,060
	<b>Pasuri e paushtime/e luajtshme</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Apartament 1+1.35 m2 Elbasan	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Letra me vlerë (600.000)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Apartament Bul Zhan Dark, Tiranë, 146 m2	-	-	8,000,000	-	-	-	-	360,906	-	-	-	-	-	-
	Blerje makine Volkswagen ***	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Mdyryshim Likuiditet	400,000	(1,495,749)	(76,173)	836,853	550,675	739,553	961,725	(275,030)	329,666	(290,006)	637,108	597,324	1,759,516	251,060
	<b>DIFERENCA (1-2-3)</b>	255,667	2,295,270	151,348	506,606	724,578	540,859	888,460	1,755,427	1,471,532	1,394,629	1,085,726	713,361	-581,130	1,327,155

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

93. Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit i rivlerësimit dhe të dhënave të tjera DSIK, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komisionin raportin me nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. \*\*, datë 1.3.2019, ku rezulton se: *formulari i deklarimit është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.*

Pas diskutimeve të Grupit të Punës u vendos dërgimi i kërkesës për verifikim të kontrollit të figurës në Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH dhe SHCBA.

94. Nga informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese rezulton se: *subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.* Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

95. Për sa më sipër, Grupi i Punës *konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.*

### **Konkluzioni për kontrollin e figurës**

96. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

96.1 Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE**

97. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kreu VI, nenin 40 e vijues i tij, si dhe mbi bazën e kritereve përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku në përfundim ky organ ka lëshuar një raport të hollësishëm.

98. Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është bazuar në: formularin e vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti; të dhënat dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin dhe që janë paraqitur nga subjekti; pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

99. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti konstatohet, si më poshtë:

1) Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar saktë me shkrim të qartë e të lexueshëm.

2) Lidhur me detyrat e kryera tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore sipas aktit të vetëvlerësimit konstatohet subjekti se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Subjekti ka punuar në Dhomën Civile të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku ka gjykuar kryesisht mosmarrëveshje civile dhe lidhur me këtë fushë ka deklaruar se disponon Master i Nivelit të Dytë, në të Drejtën Civile.

3) Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Ridvan Hado përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

## ANALIZA E GJETJEVE

### *Njohuritë ligjore*

100. Subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Tregon rastet kur ligji material është interpretuar apo zbatuar gabim nga gjykata e shkallës së parë dhe sqaron se cili është kuptimi i saktë i përmbajtjes së normës konkrete. Një rëndësi të veçantë i kushton edhe respektimit ose jo të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta, por nuk është evidentuar asnjë rast i prishjes së vendimit të shkallës së parë dhe kthim të çështjes për rigjykim, pasi është argumentuar se zbatimi i dispozitave procedurale nga shkalla e parë ishte kryer në mënyrë korrekte.

101. Tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara konfirmojnë: njohuritë e tij mbi drejtën dhe marrëdhëniet e punës; njohuritë mbi padinë e rivendikimit të sendit; njohuritë mbi parashkrimin *shues* dhe parashkrimin fitues; njohuritë mbi kontratën e sigurimit; njohuritë mbi pavlefshmërinë absolute të një akti administrativ njohuritë mbi kontratën e huas; si dhe njohuritë mbi masat e sigurimit personal në procesin penal. Për të tri dokumentet ligjore nuk ka të dhëna nëse janë ankimuar në Gjykatën e Lartë, ndërsa ndër pesë dosjet e vëzhguara janë rekursuar 3 vendime, për të cilat Gjykata e Lartë nuk është shprehur ende.

### *Arsyetimi ligjor*

102. Subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Subjekti respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar.

### *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

103. Subjekti rivlerësimit, z. Ridvan Hado, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se gjatë periudhës së rivlerësimit, i janë caktuar si relator 1088 çështje gjyqësore, ka përfunduar 907 çështje gjyqësore, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 7 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 83.3 %.

104. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtari Ridvan Hado, ka përfunduar 921 çështje, nga të cilat 41 penale themeli, 278 penale masa sigurimi, 413 çështje civile të përgjithshme, 29 çështje civile familjare, 1 çështje administrative, 28 njohje vendimesh gjyqësore të huaja dhe 131 kërkesa si pezullime, rivendosje etj.

105. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Ridvan Hado, ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Konkretisht, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 4 muaj e 24 ditë, 6 muaj e 27 ditë, por duke zbritur lejen vjetore prej një muaj, atëherë gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 27 ditë, 3 muaj e 5 ditë, 3 muaj e 17 ditë dhe 6 dite. Ndërsa në tri dokumentet ligjore, kohëzgjatja e gjykimit nuk mund të përcaktohet, pasi në përmbajtje të vendimit nuk jepen të dhëna për datën e regjistrimit të çështjes dhe datën e shortit.

106. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore te sekretarja asistuese nga gjyqtari. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Ridvan Hado, në dy raste ka respektuar afatin 20 ditor të arsyetimit, ndërsa në tre raste afati 20 ditor është tejkaluar, por në dy prej tyre vendimi është arsyetuar brenda afatit të rekursit.



107. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtarin Ridvan Hado janë paraqitur gjithsej 11 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së. Nga shqyrtimi administrativ i tyre në asnjë rast nuk është konstatuar shkelje disipline në veprimtarinë e tij gjyqësore

108. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, është eficient, efektiv dhe respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në të pesë rastet e çështjeve të përzgjedhura me short, gjykimet kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

#### *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

109. Subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Në pesë çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 5 seanca me 1 seancë dhe 2 seanca. Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 10 seanca gjyqësore, nga të cilat 8 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 2 seanca gjyqësore joproduktive është bërë mungesa e avokatit të palës paditëse që kishte dërguar raport mjekësor. Nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të vetë gjyqtarit. Përgjithësisht janë marrë masat dhe janë mbikëqyrur njoftimet e palëve. Në të 5 çështjet e vëzhguara ka pasur seanca gjyqësore që janë çelur me vonesë në orar nga planifikimi dhe shkak i vonesës nuk është dokumentuar, por ora e fillimit të tyre është dokumentuar gjithmonë saktësisht. Vonesa në fillimin e seancave nuk ka penguar ecurinë e gjyimit. Të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara janë mbajtur në përputhje me kërkesat e sistemit audio, duke i shërbyer transparencës dhe solemnitetit të procesit.

110. Gjatë gjyimit subjekti identifikon veprimet procedurale që duhen kryer, si dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë.

111. Gjyqtari Ridvan Hado zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjyimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar.

#### *Aftësia për të administruar dosjet*

112. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal, por në rastet kur seanca gjyqësore fillon me vonesë shkak i vonesës nuk dokumentohet. Përgjithësisht dosjet gjyqësore janë lehtësisht të shfrytëzueshme.

#### *Etika në punë*

113. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Ridvan Hado përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Rrjedhimisht asnjë ankesë nuk lidhet me etikën në punë. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

#### *Integriteti*

114. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ridvan Hado dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *Paanësia*

115. Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Ridvan Hado. Për vetë

gjqqtarin Ridvan Hado, nga 5 dosjet e vëzhguara, në asnjë rast, nuk është kërkuar përjashtimi i tij prej trupit gjykues. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Si në 3 dokumentet ligjore ashtu edhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, nuk ka respektuar rregullat procedurale, që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

#### *Aftësitë e komunikimit*

116. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit Ridvan Hado me palët ndërgjyqëse. Nga dëgjimi i kasetës që i bashkëlidhet dosjes gjyqësore rezultoi se komunikimi i gjyqtarit Ridvan Hado me palët pjesëmarrëse në proces, ka qenë korrekt dhe në respektim të normave etike. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

#### *Aftësia për të bashkëpunuar*

117. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Ridvan Hado për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, dhe subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

#### *Gatishmëria për t'u angazhuar*

118. Subjekti, në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 6 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ka kryer 9 ditë të formimit vazhdues për 3 vjet. Lënda e trajnimit ka lidhjen e duhur me detyrën që kryen, pasi përfshin njohuri në detyrën e gjyqtarit.

### **GJETJET E VËZHguesIT NDËRKOMBËTAR**

119. Gjatë procesit të hetimit administrativ, për subjektin e rivlerësimit, janë paraqitur dy gjetje nga vëzhguesi ndërkombëtar, të cilat janë pranuar nga Komisioni bazuar në pikën 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në kuptim të vlerësimit të zbatimit të legjislacionit material dhe procedural në vendimmarrjet kolegjiale si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe pasojave të ardhura në cenim të interesit publik.

#### **Gjetja nr. 1 e vëzhguesit ndërkombëtar**

120. Në datën 3.1.2020, në Komision është protokolluar akti gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar me nr. \*\*\* prot., e cila paraqitet si provë në kuptim të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 dhe ka për objekt vlerësimin e qasjes së subjektit të rivlerësimit në vendimmarrjen kolegjiale të marrë në KLD (organ në të cilin bënte pjesë subjekti i rivlerësimit), datë 11.10.2018, në lidhje me dhënien e lejes së posaçme magjistratit Gj.Gj, me kohëzgjatje për periudhën 1.11.2018 – 31.10.2020. Në shtjellimin e argumenteve, vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur një sërë gjetjesh, duke paraqitur analizë të dokumentacionit përkatës (ku përfshihen shtojcat bashkëlidhur kësaj gjetjeje dhe që duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e saj), bazuar në legjislacionin përkatës në atë kohë dhe procesit logjik të kryer për këtë vlerësim.

#### **Përmbajtja e Gjetjes**

121. Në media ekzistojnë opinione, sipas të cilave vendimi i marrë nga KLD-ja, datë 11.10.2018, i cili i dha magjistratit Gj.Gj leje të posaçme me kohëzgjatje 1.11.2018 – 31.10.2020, ka qenë në shkelje të ligjeve materiale dhe procedurale që ishin në fuqi në atë kohë. Sipas vëzhguesit është e nevojshme që këto pretendime të vlerësohen, pasi, nëse konfirmohen,

besimi i publikut do të cenohet rëndë nga miratimi që u dha nga magjistratët e tjerë që morën pjesë në votim.

122. Sipas vëzhguesit ndërkombëtar nuk ka në fakt asnjë lidhje, që në kuadrin e KLD-së, vendimet kanë qenë “kolegjiale”, pasi ekzistenca e të metave të rënda në procesin e vendimmarrjes nuk do të shkarkonte, për efekt të rivlerësimit, secilin prej magjistratëve nga përgjegjësia e tij/saj, parë në këndvështrimin e të ashtuquajturit “besim i publikut”. Në vlerësim të përkufizimit ligjor mbi autoritetin e KLD-së<sup>27</sup> shprehur, si më poshtë:

*“[...] autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, arsimimin, vlerësimin moral dhe atë profesional, karrierën dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe atyre të apelit”.*

123. KLD-ja duhej të vepronte sipas standardit më të lartë të zbatimit të ligjit, pasi veprimtaria e saj duhej të përbënte shembull të asaj çka do të thotë “zbatim ligji”. Kur një zbatim i tillë mungon në mënyrë të hapur dhe flagrante, do të ishte e paarsyeshme të mos i kërkohej llogari secilit nga magjistratët për miratimin e vendimeve të marra për qëllim të procesit të rivlerësimit. Një qasje e ndryshme dhe një interpretim ligjor i ndryshëm do të arrinte madje edhe të binte ndesh me Kushtetutën, pasi në pikën 1 të nenit 179/b të saj thuhet shprehimisht se një nga qëllimet e sistemit të rivlerësimit është “rikthimi i besimit të publikut” te gjyqësori.

124. Vëzhguesi ndërkombëtar parashtroi si Gjetjen nr. 1 ekzistencën e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të dispozitës së përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që ka qenë në fuqi në atë kohë) për Këshillin e Lartë të Drejtësisë (i ndryshuar), parë në këndvështrimin e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e përjashton secilin prej magjistratëve nga shkaktimi i një vlerësimi negativ në bazë të pikës 5, të nenit 61, të Ligjit të Vettingut (sa herë që po këta magjistratë kanë marrë një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kuadrit ligjor përkatës apo që kanë marrë pjesë në votim, i cili ka kontribuar për nxjerrjen e një vendimi të tillë).

125. Paraqitje përmbledhëse e kuadrit ligjor të asaj kohe, të zbatueshëm për këtë rast, në datën 11.10.2018, ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 22.11.2016, në nenin 173 (i titulluar “shfuqizime”) përcakton se:

1. *“[...] ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të neneve, si më poshtë:*

a) neni 2, germat “b”, “ç”, “d”, “dh”;

b) nenet 3, 4, 5, neni 6, pika 3, neni 7, pika 1, neni 8, pikat 1 dhe 2, nenet 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

2. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, shfuqizohet, në tërësi, menjëherë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Deri në zbatimin e sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të tjera për magjistratët, që hyn në fuqi në datën 1.1.2019, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, do të qëndrojnë në fuqi dispozitat, si më poshtë:

<sup>27</sup>Neni 1 i ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar.

Rregullimet për pagat e gjyqtarëve, të parashikuara në nenet 26 dhe 27, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar [...].

Duke pasur parasysh sa më sipër, nenet 2 (pjesërisht), 11, 12, 13, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27, të ligjit nr. 8811/2002 kanë qenë ende në fuqi në datën 22.11.2016, pasi janë ruajtur nga neni 173 i ligjit nr. 96/2016.

126. Vlen të përmendet se formulimi i pikës 3 të po këtij neni (173) duket se nënkupton se “lejet e tjera”, të parashikuara nga neni 24 i ligjit nr. 96/2016 (njëra prej tyre iu dha magjistratit Gj. Gj gjatë seancës së datës 11.10.2018 të KLD-së) mund të jepej vetëm pas datës 1.1.2019 dhe jo më herët, pasi do të kishte arsye të konsiderohej si përfitime të tjera, të përjashtuara nga përjashtimet e nënpikave të pikës 3 të nenit 173, ndërsa nenet 26 dhe 27, të ligjit nr. 9877/2008 kishin të bënin me pagesat e pagave (përlllogaritjet), të përfshira në përjashtimet e nënpikave të pikës 3 të nenit 173.

127. Pra, ndonëse ligji për statusin ka hyrë në fuqi më 22.11.2016, ka një argument ligjor, sipas të cilit, zbatimi i nenit 24 të këtij ligji ka qenë “i ngrirë” deri më 1.1.2019.

Gjithashtu, duhet të merret parasysh edhe që neni 290 (i titulluar “shfuqizime”) i ligjit nr. 115/2016, i cili ka hyrë në fuqi në datën 16.12.2016, ka përcaktuar që ligji nr. 8811/2001, i ndryshuar: “[...] shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rregullave që lidhen me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që i referohet ushtrimit të kompetencave sipas nenit 160 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë[...]”.

Në pikën vijuese nr. 2, të nenit 290, të ligjit nr. 115/2016 thuhet se ligji për KLD-në “shfuqizohet në tërësi, menjëherë, pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

128. Nëse neni 290 i ligjit nr. 115/2016, do të lexohej në mënyrë të ndërthurur me nenin 160<sup>28</sup> të ligjit nr. 96/2016, edhe në këtë rast, konkluzioni i mundshëm është që Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk do të mund të mbledhej për t’u dhënë magjistratëve përfitimet e parashikuara nga neni 24 i ligjit nr. 96/2016, duke qenë se një përfitim i tillë do të fillonte përpara datës 1.1.2019.

128.1 Në po të njëjtin përfundim mund të arrihej edhe nga dispozita e pikës 5, të nenit 169, të ligjit nr. 96/2016 (që mban titullin: “dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve”) që parashikon: “[...] 5. Pjesa II, kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën

<sup>28</sup>Në nenin 160 të ligjit nr. 96/2016, në pjesën që ka lidhje me Këshillin e Lartë Gjyqësor, që do të krijohet në të ardhmen thuhet, si vijon:

“1. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj:

a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) merr vendim për caktimin në pozicion të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

c) vendos masa disiplinore me propozim të ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji;

ç) pezullon gjyqtarët, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj;

d) mbikëqyr trajnimin e gjyqtarëve, sipas këtij ligji dhe ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

dh) kryen vlerësimin e punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

e) vendos masa disiplinore për inspektorët, bazuar në aktet nënligjore në fuqi;

f) vërteton ndërprerjen e emërimit, në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit;

g) transferon përkohësisht gjyqtarë për plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata.[.].”

*e Shqipërisë”, pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1.1.2019. Përjashtim nga ky rregull bëjnë magjistratët në institucionet për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, të cilët përfitojnë pagat dhe përfitimet e tjera, sipas këtij ligji, me caktimin në mënyrë të përhershme në këtë pozicion. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për magjistratin, i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitime të tjera [...].”*

129. Megjithatë, duke u ndodhur në situatën ku do të mund të pranohej mundësia që kishte KLD-ja për të vendosur të mblidhej në datën 11.10.2018 dhe t'i jepte magjistratit një leje, në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 96/2016<sup>29</sup>, procedura që do të ndiqej duhej të ishte në përputhje me dispozitat ligjore që rregullonin veprimtarinë e saj në atë kohë, që garantohen nga neni 173 i ligjit nr. 96/2016.

130. Për pasojë, nëse do ta pranojmë mundësinë që KLD-ja të diskutonte për këtë çështje, vëzhguesi ndërkombëtar do të nxirrte përfundimet duke shqyrtuar atëherë mënyrën me të cilën u krye procesi, duke marrë parasysh dokumentacionin e disponueshëm, të administruar prej saj.

131. Procedura e ndjekur nga KLD-ja për marrjen e vendimit mbi kërkesën e magjistratit Gj Gj, në datën 11.10.2018, nga dokumentacioni që disponohet, nuk rezulton apo nuk mund të vërtetohet në mënyrë të arsyeshme se procesi që çoi në vendimin për dhënien e lejes për periudhën 1.11.2018 – 31.10.2020, në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 96/2016, ka qenë në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, siç ka qenë në fuqi në datën 11.10.2018.

Si vërejtje e përgjithshme edhe pas analizimit të përgjigjes së KLGJ-së, së datës 11.12.2019 (nr. \*\*\* prot.), dërguar vëzhguesit ndërkombëtar, ende nuk është i qartë justifikimi për urgjencën me të cilën është thirrur mbledhja brenda më pak se 24 orëve, e cila vërtitej rreth vendimit të Komisionit datë 10.10.2018, me të cilin u shkarkua nga detyra subjekti i rivlerësimit, znj. E. P, në bazë të dispozitave të pikës 3<sup>30</sup>, të nenit 20, të ligjit nr. 8811/2001<sup>31</sup>.

Analiza e ngjarjeve që kanë ndodhur midis datave 10 dhe 11.10.2018, shkakton dyshimin e arsyeshëm që mbledhja u thirr në datën 10.10.2018 me qëllim, posaçërisht, diskutimin për kërkesën e magjistratit Gj.Gj, e cila formalisht u mor në dorëzim të KLD-së ditën vijuese (nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2018).

132. Edhe nëse e marrim si të mirëqenë natyrën e jashtëzakonshme të mbledhjes së KLD-së, e cila ndodhi më 11.10.2018, duhet të vihet në dukje se çështja në lidhje me kërkesën e magjistratit Gj.Gj nuk ishte përfshirë në rendin fillestar të ditës për këtë mbledhje, por u shtua më vonë. Vëzhguesi ndërkombëtar do të dëshironte të paraqiste si Gjetjen nr. 2, provat që përfshirja e kësaj pike në rendin e ditës u bë në shkelje flagrante të ligjit, pasi pika 6, e nenit 22, të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, siç ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjeve, parashikonte: “[...] Përjashtimisht, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të marrë në shqyrtim dhe të vendosë për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës.”<sup>32</sup>

<sup>29</sup>Mund të merren në konsideratë – ndonëse nuk kemi për t'i shqyrtuar – edhe ato që lidhen me parimet e shprehura, *mutatismutandis*, nga vendimi nr. 34/2017 i Gjykatës Kushtetuese, që ka shfuqizuar pikën e fundit të pikës 5, të nenit 169, të ligjit nr. 96/2016, në pjesën ku thuhet se: “Gjatë periudhës së rivlerësimit, për magjistratin, i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitime të tjera magjistratëve”. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar një diferencim për sa u përket përfitimeve që do t'u jepeshin, në varësi të faktit nëse janë rivlerësuar apo nuk janë rivlerësuar.”

<sup>30</sup>(Neni 20, ligji nr. 8811/2001, i ndryshuar).

<sup>31</sup>Duhet të vihet në dukje se neni 21 i ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, ka përcaktuar afate më të shkurtra për të thirrur “Mbledhje të Jashtëzakonshme të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, por kjo dispozitë nuk ishte më në fuqi pas hyrjes në fuqi të nenit 173 të ligjit nr. 96/2016 dhe për më tepër, nuk e përfshinte çështjen në fjalë.

<sup>32</sup>Teksti i plotë i nenit 22 të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar.

132.2 Nuk ka procesverbal dhe as ndonjë provë tjetër shkresore të besueshme që KLD-ja të ketë votuar ndonjëherë që të zbatojë dispozitën për të përfshirë kërkesën e magjistratit Gj. Gj në pikat e rendit të ditës së mbledhjes, e cila u zhvillua në datën 11.10.2018.

133. Për më tepër që nuk ka prova që magjistrati Gj. Gj të ketë braktisur sallen gjatë votimit dhe, për pasojë, nuk ka prova që të jetë zbatuar pika 2, e nenit 25, të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, në pjesën ku thuhet: “[...] 2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që janë në kushtet e pengesës ligjore, nuk marrin pjesë në diskutimin dhe në votimin e çështjes përkatëse të rendit të ditës.”

134. Gjithashtu, në pikën 2, të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016, që rregullon “lejet e tjera” thuhet, si vijon: “Leja e veçantë miratohet nga kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Këshillat miratojnë lejen prindërore, pasi kanë marrë mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë. [...]”.

135. Dosja që vëzhguesi ndërkombëtar ka marrë nga KLD-ja më 11.12.2019, përmban një vendim të datës 11.10.2018 (e njëjta datë me datën e mbledhjes së KLD-së), në të cilën kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë (tashmë ish-kryetar), gjyqtari H. D, ka miratuar kërkesën për leje të parashtruar nga magjistrati Gj. Gj, megjithatë, nuk ka prova shkresore të besueshme që magjistrati ta ketë përftuar këtë vendim përpara se t’i parashtronte kërkesën KLD-së.

136. Por, kjo kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2018 mbante datën 10.10.2018, një ditë përpara datës së miratimit të dhënë nga ish-kryetari H.D. Madje as nuk është e sigurtë nëse miratimi i kryetarit ka ndodhur efektivisht më herët se data 11.10.2018, pasi nuk ka numër të besueshëm protokollit nga Gjykata e Apelit Tiranë, që do të mund të tregonte datën e marrjes së vendimit, në pjesën e sipërme majtas të dokumentit të nënshkruar nga (tashmë ish-) kryetari, shënohet “nr. *extra* prot.”, një formulim i cili përdoret për t’iu referuar shkresave që u shtohen *ex-post* numrave të protokollit të një dite të caktuar.

136.1 Për pasojë, rezulton qartë ekzistenca edhe e shkeljes së pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016, në procesin që çoi KLD-në të miratonte kërkesën e magjistratit Gj. Gj, drejtuar KLD-së më 10.10.2018.

### **Konkluzion**

137. Duke pasur parasysh sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar i paraqet Komisionit këto gjetje:

- 1) Ekzistenca e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), i ndryshuar, duke pasur parasysh nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat [nga përgjegjësia] që t’i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5, të nenit 61, të Ligjit të Vettingut, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kornizës ligjore përkatëse apo që kanë marrë pjesë në votim, i cili ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë.
- 2) Shkelja flagrante në procesin që e çoi KLD-në më 11.10.2018 t’i jepte magjistratit Gj. Gj leje për periudhën 1.11.2018 – 31.10.2020 dhe posaçërisht, shkeljet flagrante dhe të hapura të dispozitave të pikës 6 të nenit 22, pikës 2 të nenit 24 dhe pikës 2, të nenit 25, të ligjit nr. 8811/2001, i ndryshuar, siç ka qenë në fuqi në atë kohë, si dhe të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016, për shkaqet e shprehura në këtë dokument.

138. Shkeljet e dukshme që janë përshkruar në këtë gjetje, duhet të marrin vlerësim negativ nga Komisioni për sa i përket subjektit të rivlerësimit Ridvan Hado, i cili mori pjesë në vendimin me të cilin u miratua kërkesa për leje e magjistratit Gj. Gj. Një vendim i marrë nga autoriteti më i lartë, i ngarkuar me përfundimin e gjyqësorit në kohën e ngjarjes dhe që nga shumica dërrmuese e popullsisë konsiderohej se i takonte, ashtu si edhe institucione të tjera publike, të vendoste standardin e sundimit të ligjit në Shqipëri, për sa i përket ligjshmërisë.

139. Vëzhguesi e përmbyll gjetjen me arsyetimin se në rastin konkret, me mosveprimet e tij, subjekti Ridvan Hado ka kontribuar në cenimin e besimit të publikut te institucionet e gjyqësorit dhe, për pasojë, një gjendje e tillë duhet të merret parasysh nga Komisioni, në kuadrin e pikës 5, të nenit 61, të Ligjit të Vettingut.

Komisioni, kërkoi shpjegime të subjektit mbi gjetjen nr. 1 të vëzhguesit ndërkombëtar.

#### **Gjetja nr. 2 e vëzhguesit ndërkombëtar**

140. Në Komision është protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020 akti gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar. Vëzhguesi ndërkombëtar i ka kërkuar informacione Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj), në lidhje me mbledhjen e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD), e zhvilluar më 10.2.2017, me qëllim vlerësimin e qasjes së subjektit të rivlerësimit në vendimin ku KLD-ja (organ në të cilin bënte pjesë subjekti i rivlerësimit) vendosi të rrëzonte propozimin e bërë nga ministri i atëhershëm i Drejtësisë, për procedim disiplinor të gjyqtarit P.A, në Gjykatën e Apelit Vlorë<sup>33</sup>.

141. Objekti i analizës ka për qëllim të vlerësojë nëse qasja e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje, me veprimet e tij aktive apo pasive, ka treguar një profesionalizëm që nuk do të cenonte besimin e publikut te gjyqësori. Në shtjellimin e argumenteve, vëzhguesi ndërkombëtar do të paraqesë një sërë gjetjesh, në bazë të pikës 10, të nenit 49, të Ligjit të Vettingut. Për pasojë, vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit që Komisioni, duke iu mbështetur edhe dispozitave të nenit 52 të Ligjit të Vettingut, nëse është e nevojshme, duhet të bëjë kërkime dhe të hetojë mbi votimin e subjektit të rivlerësimit për çështjen në fjalë gjatë mbledhjes së KLD-së, më 10.2.2017, për të mbledhur elementet e nevojshme me qëllim që të arrijë në përfundimet më të mira, duke pasur parasysh pikën 5, të nenit 61, të ligji nr. 84/2016.

#### **Përmbajtja e gjetjes dhe analiza e kuadrit ligjor përkatës**

142. Siç është shtjelluar tashmë në një gjetje tjetër, për këtë subjekt rivlerësimi më 13.1.2020 vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se ashtu si në Gjetjen nr. 1, ekzistenca e një standardi ligjor në përputhje me interpretimin e orientuar nga Kushtetuta të dispozitës (që në atë kohë ka qenë dispozita përkatëse në fuqi) së nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001, “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë” (i ndryshuar), në këndvështrimin e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e pengon që për secilin magjistrat të bëhet një vlerësim negativ, në bazë të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, sa herë që po këta magjistratë kanë mbështetur apo kanë dhënë një vendim të KLD-së, në shkelje flagrante të kuadrit ligjor të zbatueshëm apo që kanë marrë pjesë në votimin që ka kontribuar për marrjen e një vendimi të tillë.

143. Gjithashtu, vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit, si Gjetje nr. 2, që mungesa e një përgjegjësie penale për një veprim që përfshihet në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalon KLD-në që të vlerësojë ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe penale mund të trajtohen në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës).

144. Për pasojë, si Gjetje nr. 3, vëzhguesi ndërkombëtar konstaton se ligji i zbatueshëm i asaj kohe për vlerësimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë, nuk parashikonte asnjë nënshtrim të hetimit disiplinor me qëllim vërtetimin e shkeljeve disiplinore të përshkruara në germën “ç”<sup>34</sup>, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008, që ka qenë atëherë në fuqi, si dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>35</sup> në fund, për ekzistencën e përgjegjësisë penale për të

<sup>33</sup>Duhet të vihet në dukje që mbledhja e KLD-së u realizua një vit pas datës së dorëzimit të kërkesës së ministrit të Drejtësisë.

<sup>34</sup>[.. ] ç) refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive; [... ] (germa “ç”, e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008).

<sup>35</sup>[... ] 3. Për shkeljet shumë të rënda që parashikohen në pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në germën “d”, të pikës 2, të këtij neni [ ... ] (shkarkimi nga detyra — n.o.a.)” (pika 3, e nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008).

njëjtat veprime që përshkruhen në nenin 257/a të Kodit Penal të Shqipërisë, që ishte i zbatueshëm për atë çështje, siç ishte në fuqi atëherë.

145. Për pasojë, si Gjetje nr. 4, vëzhguesi ndërkombëtar konstaton se elementet për vlerësimin e ekzistencës së shkeljes disiplinore që përshkruhen në germën “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008<sup>36</sup> janë të ndryshme nga elementet për të vlerësuar ekzistencën e krimit të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal dhe se në veçanti, germa “ç”, e pikës 2, të nenit 32, të ligjit të mëparshëm nr. 9877/2008 nuk parashikon, si parakusht, ekzistencën e ndonjë mase të mëparshme administrative (si p.sh., masë disiplinore nga KLD-ja apo gjoba të vendosura nga organe të tjera administrative, si ILDKPKI-ja).

146. Në nenin 257/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, në versionin aktual (ligji nr. 7895/1995, i ndryshuar), thuhet: *“Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative”* (theksimi i shtuar).

147. Në një gjuhë të ngjashme, në versionin e konsoliduar të nenit 257/a të Kodit Penal më 1.12.2004, thuhet:

*“Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.*

*Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”*, (theksimi i shtuar).

148. Për pasojë, në lidhje me këtë dispozitë janë bërë disa ndryshime, ndonëse elementet thelbësore kanë mbetur të njëjtë për sa i përket anës materiale. Faktikisht, është mëse e qartë që formulimi “kur më parë janë marrë masa administrative” u referohet edhe masave disiplinore, të cilat, në vetvete (*per se*) janë të një natyre administrative.

149. Marrja e masave të mëparshme administrative për veprimet e përshkruara në pjesën e parë të nenit 257/a të Kodit Penal, përbën një element thelbësor (parakusht) për kryerjen e krimit, pa të cilin nuk është e mundur që një magjistrat të konsiderohet se ka përgjegjësi penale për këtë veprim. Për pasojë, sanksioni penal (dhe procedimi) për veprimet e parashikuara në pjesën e parë të nenit 257/a të Kodit Penal, i nënshtrohet dhënies së masës disiplinore dhe jo anasjellas (*vice versa*).

150. Në legjislacionin aktual dhe në legjislacionin që ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjeve, nuk ka asgjë që dhënien e masës disiplinore dhe nisjen e një hetimi disiplinor nga organi vetëqeverisës i magjistratëve (KLD-ja), t’ia nënshtrojë një sanksioni penal për veprimet e parashikuara nga neni 257/a i Kodit Penal.<sup>37</sup>

151. Në fakt duket se është e kundërta për këtë veprim specifik, që është konsideruar nga germa “ç”, e pikës 2, të nenit 32, të ligjit të mëparshëm nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” si një shkelje shumë e rëndë disiplinore e cila ka sjellë si pasojë, si masë disiplinore, mosshkarkimin e magjistratit nga detyra (shihni pikën 3, të nenit 33, të ligjit nr. 9877/2008).

<sup>36</sup>Shihni më sipër shënimin fundor nr. 2.

<sup>37</sup>Për sa i përket dispozitës së ligjit aktual nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” fakti që germa “dh”, e nenit 103 parashikon një shkelje disiplinore të posaçme për [...] shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit, në veçanti në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit, sipas ligjit, në një nen tjetër që ka të bëjë me “shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale (neni 104), vërteton prapë prapë ndryshim në bazë të vlerësimit të një veprë penale, krahasuar me shkeljen disiplinore.



152. Një përfundim i tillë përputhet me parimet e shprehura, ndonëse në një çështje dhe gjendje të ndryshme, nga vendimi nr. 15, i datës 3.5.2011, i Gjykatës Kushtetuese (V – 15/11), i cili përcaktonte se: *“Gjykata ka theksuar në praktikën e saj se, si rregull, përgjegjësia penale konkurron me përgjegjësinë administrative ose disiplinore. Prandaj, pavarësisht nga procedimi penal, Këshilli i Ministrave, si organ administrativ, mund të nisë njëherazi një procedurë administrative për shkelje, për të cilat konstatohet përgjegjësi administrative (vendim nr. 22/2008 i Gjykatës Kushtetuese) [...]”*<sup>38</sup>.

153. Pra, në momentin e ngjarjes, hetimi disiplinor me qëllim vërtetimin e shkeljeve disiplinore që parashikohen në germen “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008 – dhe dhënien e masës së duhur disiplinore në fund, nuk i nënshtrohej ekzistencës së një përgjegjësie penale për të njëjtat veprime që përshkruhen në nenin përkatës 257/a të Kodit Penal.

154. Gjithashtu do të ishte e palogjikshme që institucioni vetëqeverisës i magjistratëve t’u nënshtrohej vendimeve për masa, që në fund nuk janë vendosur (“dhënë”) nga organe të tjera administrative (si ILDKPKI-ja) gjatë inspektimit të tyre. Kjo është arsyeja që formulimi i germës “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit të atëhershëm nr. 9877/2008, nuk i referohej “masave disiplinore” të mëparshme apo “masave administrative” të mëparshme (kjo e fundit në përputhje me formulimin më të gjerë të versionit të mëparshëm të nenit 257/a të Kodit Penal).

155. Duke pasur parasysh sa më sipër, vendimi i marrë nga KLD-ja, në përfundim të mbledhjes së datës 10.2.2017 dhe argumentet e paraqitura në të nga magjistratët Gj. Gj dhe G. H, si në procesverbalin që përbën pjesë të shtojcave ndaj këtij dokumenti, rezulton i pabazuar. Megjithatë, nuk është e qartë qasja dhe mënyra e votimit të subjektit Ridvan Hado, ndonëse vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se KLD-ja duhej të kishte shqyrtuar imtësisht dokumentacionin shoqëruar në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, të Prokurorisë brenda Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të përcaktuar nëse u krye siç duhej hetimi dhe pretendimet e ILDKPKI-së kanë qenë të sakta për të verifikuar ekzistencën e një përgjegjësie disiplinore të gjyqtarit P.A, në bazë të germës “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008, që ka qenë atëherë në fuqi.

156. Vëzhguesi Ndërkombëtar ka bërë një analizë përmblendhëse për disa probleme të shënuara nga çështja e prokurorisë, vendimi nr. \*\*\* i së cilës ka lidhje me Gjetjen nr. 5, që paraqitet këtu, pasi përmban informacione që do të mund të ishin vërtetuar nga KLD-ja, nëse kjo e fundit do të kishte vepruar siç duhej në kohën e ngjarjeve. Vëzhguesi ndërkombëtar ka konstatuar:

157. Mungesë hetimi për konflikt interesash; mungesë hetimi për automjetin që ka blerë në vitin 2009, i biri i z. P.A (në shumën 7,000 euro), i cili ka mbështetur deklarin e tij në ILDKPKI, duke thënë se të ardhurat janë siguruar nga puna si truporë në Greqi gjatë sezoneve verore. Këto deklarime nuk rezultojnë të mbështetura nga asnjë dokument ligjor; mungesë hetimi për shumën prej 50,000 USD, të marrë nga i biri i z. P.A, në vitin 2008, nëpërmjet një transaksioni bankar; mungesë hetimi mbi borxhet që ka marrë z. P. A, si dhe legjitimitetin e tyre; mungesë hetimi për të ardhurat prej afro 47,000 USD, të marra brenda tre muajsh (siç është deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2005, por që më vonë, kur është intervistuar nga ILDKPKI-ja, kjo ka ndryshuar në një vit punësimi si avokat i lirë) nga dy firma (“V.B” dhe “B. CO sh.p.k.”). Në përgjigjen e datës 1.7.2015 (nr. \*\*\*

prot.), të U.F.T (një institucion financiar) drejtuar prokurorisë Elbasan, raportohet se *“shtetasit për të cilët po bëni kërkime kanë kryer transferta monetare, por, që t’ju përgjigjemi hollësisht, me qëllim që të respektohet privatësia e subjekteve, nga prokuroria duhet vendim sekuestrimi*

<sup>38</sup>“Gjykata ka theksuar në praktikën e saj se, si rregull, përgjegjësia penale konkurron me përgjegjësinë administrative apo disiplinore. Për pasojë, pavarësisht nga procedimi penal, organi administrativ i Këshillit të Ministrave, mund të nisë njëherazi një procedurë administrative për shkelje, për të cilat konstatohet përgjegjësi administrative (vendim nr. 22/2008 i Gjykatës Kushtetuese) [...]”.

për hetimin e çështjes për veprat penale të kryera në vendin tonë, në bazë të nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale”. Duket se nuk u dërgua letër e dytë nga prokuroria për hetim të mëtejshëm, pasi nuk rezulton në dosjen përkatëse.

157. Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia: duket se z. P. A ka ankimuar vendimin e Prokurorisë Elbasan, me qëllim që të përfonte një vendim më të favorshëm, duke pretenduar se prokurori duhej të kishte nxjerrë përfundimin se “fakti nuk ekziston”, në bazë të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale<sup>39</sup>. Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka çmuar se prokurori kishte kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme dhe ka konkluduar në kuptimin e mungesës së elementeve objektive dhe subjektive për kryerjen e krimit. Për pasojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka deklaruar se vendimi për rrëzimin e procedimit penal nga prokurori ka qenë në përputhje me germën “b” të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk u ankimua në Gjykatën e Apelit Durrës<sup>40</sup>.

### Konkluzion

158. Duke pasur parasysh sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar i paraqet Komisionit këto gjetje:

1) Ekzistencë e një standardi ligjor sipas interpretimit të orientuar nga Kushtetuta të nenit 18 të ligjit nr. 8811/2001 (që në atë kohë ka qenë në fuqi), i ndryshuar, duke pasur parasysh nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në kuptimin që “kolegjialiteti” i KLD-së nuk e liron secilin magjistrat nga përgjegjësia, që t’i bëhet vlerësim negativ, në bazë të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, sa herë që po këta magjistratë kanë miratuar një vendim të KLD-së në shkelje flagrante të kornizës ligjore përkatëse apo që kanë marrë pjesë në votim, i cili ka kontribuar në nxjerrjen e një vendimi të tillë.

2) Mungesa e përgjegjësisë penale për një veprim të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal, nuk e ndalon KLD-në që të vlerësojë ekzistencën e një shkeljeje disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi dhe se procedimet disiplinore dhe penale mund të trajtohen në mënyrë autonome (me kusht që elementet e krimit dhe/ose të shkeljes disiplinore të vërtetohen në procedimin përkatës).

3) Ligji i zbatueshëm i asaj kohe për vlerësimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë, nuk parashikonte asnjë nënshtrim të hetimit disiplinor me qëllim vërtetimin e shkeljeve disiplinore të përshkruara në germën “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008, që ka qenë atëherë në fuqi dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>41</sup> në fund, për ekzistencën e përgjegjësisë penale për të njëjtat veprime që përshkruhen në nenin 257/a të Kodit Penal, që ishte i zbatueshëm për atë çështje, siç ishte në fuqi atëherë.

4) Elementet për vlerësimin e ekzistencës së shkeljes disiplinore që përshkruhen në germën “ç”, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008<sup>42</sup>, janë të ndryshme nga elementet për të vlerësuar ekzistencën e krimit të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal të Shqipërisë dhe se, në veçanti, germa “ç”, e pikës 2, të nenit 32, të ligjit të mëparshëm nr. 9877/2008 nuk parashikon, si parakusht, ekzistencën e ndonjë mase të mëparshme administrative (si p.sh., masë disiplinore nga KLD-ja apo gjoba të vendosura nga organe të tjera administrative, si ILDKPKI-ja).

159. Shkeljet e dukshme që janë përshkruar sa më sipër duhet të vlerësohen për sa i përket mënyrës me të cilën ka votuar subjekti Ridvan Hado në përfundim të mbledhjes së KLD-së së

<sup>39</sup>Vendim nr. \*\* (13-2016-3613.13), datë 4.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>40</sup>Informacionet e mësipërme konfirmohen edhe nga z. P.A gjatë mbledhjes së KLD-së datë 10.2. 2017, ku është shprehur: “Unë e kam bërë thjesht ankimin, duke qenë se e di që vendimet e prokurorisë në çdo kohë hapen (duke qenë se jam vetë jurist). Vjen ndonjë prokuror tjetër, i vinte mendja dhe të thoshte ‘hajde ta fillojmë nga e para’ dhe për këtë shkak e çova në gjykatë, për të marrë vendimi formë të prerë (po e doni shqip). Kjo është më e ndershme dhe po jua them kështu, se e di që unë me vendimin e prokurorisë dakord isha [...]”. –Pjesë nga përkthimi i bërë nga ONM-ja në gjuhën angleze i procesverbalit të KLD-së datë 10.2.2017).

<sup>41</sup>... ] 3. Për shkeljet shumë të rënda që parashikohen në pikën 2 të nenit 32 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në germën “d”, të pikës 2, të këtij neni [ ... ] (shkarkimi nga detyra — n.o.a.)” (pika 3, e nenit 32, të ligjit nr. 9877/2008).

<sup>42</sup>Shihni më sipër shënimin fundor nr. 2.

datës 10.2.2017 dhe Komisioni duhet të përdorë instrumentet e veta hetimore, në ndërthurje me urdhërimet e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të identifikuar vendimin e subjektit të rivlerësimit në atë moment.

160. Nëse vërtetohet se subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka votuar në përputhje me argumentet e paraqitura nga kolegët e tij, magjistratët Gj.Gj dhe G.H, duke rrëzuar kërkesat e bëra nga Ministria e Drejtësisë për procedimin disiplinor dhe dhënie të masës disiplinore ndaj gjyqtarit P.A, një gjendje e tillë duhet të marrë vlerësim negativ nga Komisioni, për sa i përket subjektit të rivlerësimit.

161. Vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se në konstatimin e votimit kundër propozimit të ministrit të Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka kontribuar në mënyrë aktive për cenimin e besimit të publikut ndaj institucioneve gjyqësore dhe, si e tillë, një gjendje e tillë duhet të merret parasysh nga Komisioni në kuadrin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

162. Nga Komisioni duhet të nxirren përfundimet e ngjashme, nëse subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, shfaq ngurrim dhe mungesë bashkëpunimi për të treguar votën apo sjell si argument që vendimet e marra nga KLD-ja kanë qenë vendime “kolegjiale” për shkak të Gjetjes nr. 1, të paraqitur nga ky vëzhgues ndërkombëtar.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova që provojnë se nuk ka votuar kundër propozimit të ish-ministrit të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të subjektit P. A.

163. Komisioni, gjatë hetimit administrativ të kryer kryesisht për subjektin e rivlerësimit, e ka pyetur subjektin mbi qëndrimin që ka mbajtur lidhur me kërkesën e paraqitur nga ish-ministri i Drejtësisë për shkarkimin nga funksioni i gjyqtarit të subjektit, z. P.A, mbi votën e tij në mbledhjen e mbajtur nga KLD-ja në datën 10.2.2017.

Në përgjigje të pyetësorit, subjekti është shprehur<sup>43</sup>: “Në lidhje me votën time si anëtar i KLD-së, në mbledhjen e saj të datës 10.2.2017, dua të sqaroj se KLD-ja është organ kolegjial, vendimmarrja e së cilës bëhet në mënyrë kolegjiale. Në ligjin për KLD-në nuk parashikohet që anëtari i saj të argumentojë votën e tij”.

164. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën përcjellëse me nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2019, lëshuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe procesverbalin e mbledhjes së datës 10.2.2017. Komisioni e administroi procesverbalin e kësaj mbledhjeje, në kuadër të vlerësimit të qëndrimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe votës së paraqitur prej tij dhe konstatoi:

165. Procesverbali i mbledhjes së datës 10.2.2017, nuk i ka ekstremitetet e nevojshme të regjistrimit zyrtar në regjistrin e mbledhjeve të KLD-së (konkretisht, procesverbali nuk ka numër protokolli dhe datë regjistrimi) dhe nuk është firmosur nga kryetari/zëvendës kryetari i saj, por vetëm nga personi që ka redaktuar procesverbalin e mbledhjes së mbajtur *audio*.

166. Në mbledhje ishin të pranishëm kryetari dhe 11<sup>44</sup> anëtarë të KLD-së. Në procesin e votimit, lidhur me propozimin e ministrit për shkarkim nga detyra të subjektit P.A, konstatohet se kanë votuar pro vetëm 3 anëtarë dhe kundër 6 anëtarë të tjerë, duke e rrëzuar në përfundim kërkesën e ish-ministrit të Shëndetësisë. Nga procesverbali nuk identifikohet përkatësia e secilës votë të dhënë në procesin e votimit.

167. Gjithashtu, trupi gjykues, datë 11.6.2020, vendosi dhe njoftoi subjektin për riçeljen e hetimit administrativ për marrjen e regjistrimit *audio* të mbledhjes së datës 10.2.2017, me rend

<sup>43</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit II, dërguar nga subjekti elektronikisht në adresë të Komisionit datë 22.11.2019.

<sup>44</sup>Ish-ministri i Shëndetësisë është larguar gjatë shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës.

dite propozim për shkarkim nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Vlorë, z. P.A, në të cilin, gjithashtu, nuk identifikohet përkatësia e secilës votë të dhënë në procesin e votimit.

168. Komisioni, lidhur me këto dy gjetje, që vëzhguesi ndërkombëtar i paraqiti Komisionit pasi administroi dhe vlerësoi prapësimet e subjektit mban qëndrimin se subjekti, në cilësinë e anëtarit të KLD-së, nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, veprimtari e subjektit në funksionin e tij si anëtar i KLD-së, funksion për të cilin magjistrati ka përgjegjësi për votën e dhënë nëse në të ka shkelje flagrante të kornizës ligjore përkatëse.

169. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, në funksionin e tij si anëtar i KLD-së, për këto dy raste, brenda një afati 5-vjeçar, duhet të jenë objekt i një hetimi të plotë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj gjyqtarit dhe gjithë veprimtarisë së ushtuar prej tij në funksion të këtij statusi, për të arritur në një konkluzion në lidhje me këto aspekte të punës së këtij magjistrati.

### **Konkluzioni për vlerësimin e aftësisë profesionale**

170. Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme dhe në argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; dhe (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

170.1 Trupi gjykues vendosi transferimin e Gjetjes nr. 1 të vëzhguesit ndërkombëtar të monitorimit, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 3.1.2020, dhe Gjetjes nr. 2, të vëzhguesit ndërkombëtar të monitorimit, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*prot., datë 20.1.2020, pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, për subjektin bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **DENONCIMET**

171. Në Komision janë protokolluar 21 denoncime si vijon.

**171.1 Denoncim nr. \*\*\*prot., datë 23.1.2018**, paraqitur nga shtetasi S.P, drejtuar disa subjekteve, ndër të tjera, edhe subjektit të rivlerësimit bashkë me dy subjekte të tjera, anëtarë të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë. Komisioni, pasi administroi këtë denoncim dhe aktet bashkëlidhur, evidentoi se denoncuesi i referohet për korrupsion dy subjekteve të tjerë rivlerësimi, anëtarë të këtij trupi gjykues dhe nuk ka përfshirë subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion lidhur me këtë denoncim dhe as të dhëna referuese lidhur me vendimet e Gjykatës së Apelit. Për rrjedhojë, ky denoncim duket se nuk është i qartë dhe bëhet i pamundur për t’u trajtuar nga Komisioni.

**171.2 Denoncim nr. \*\*\*prot., datë 7.2.2018**, paraqitur nga shtetasi S.R, drejtuar disa subjekteve, ndër të tjera, edhe subjektit të rivlerësimit, në të cilin ka bashkëlidhur disa fakte që lidhen me konflikte gjyqësore pasurore ndër vite, midis denoncuesit (familjarëve të tij) dhe familjes K. Komisioni e administroi denoncimin dhe nuk gjeti fakte dhe as vendime gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit (si gjyqtar i vetëm apo si anëtar në trup gjykues).

**171.3 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018**, paraqitur nga shtetasi S.R ndaj disa subjekteve përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Ky denoncim ka në objekt ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. \*\*\*, datë 8.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. \*\*, datë 8.11.2000. Komisioni e administroi denoncimin dhe evidentoi se trajton të njëjtat fakte si te denoncimi më lart me nr. \*\*\* prot. Nuk u gjetën fakte të lidhura me subjektin e rivlerësimit.

**171.4 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2018**, paraqitur nga shtetasi H.R, drejtuar disa subjekteve. Nga përmbajtja e denoncimit dhe dokumentacionit bashkëlidhur referohet emri i subjektit të rivlerësimit si anëtar trupi i Gjykatës së Apelit lidhur me një vendim të ndërmjetëm të dhënë për mospranimin e kërkesës për përjashtimin e një subjekti rivlerësimi, gjyqtar i një trupi tjetër gjykues. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur dokumentacion mbi të cilin mbështeten faktet.

**171.5 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2019**, paraqitur nga shtetasi H.R, drejtuar subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi denoncon subjektin për korrupsion, duke referuar të njëjtat rrethana si denoncimi me nr. \*\*\* prot., trajtuar më lart. Nga trajtimi i këtij denoncimi, Komisioni nuk evidentoi *indicie* për subjektin e rivlerësimit në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

**171.6 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2018**, paraqitur nga shtetasi S.L ndaj tri subjekteve (përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit) anëtarë të një trupi gjykues të Gjykatës së Apelit, me objekt vlerësim të aftësive profesionale dhe etike. Nga administrimi i këtij denoncimi, ndër të tjera, Komisioni evidenton se sipas denoncuesit ky trup nuk ka marrë parasysh kërkesën e justifikuar për shtyrje seance, sipas së cilës përpara seancës së datës 21.12.2017, avokati i tij ka depozituar një kërkesë për shtyrje për shkaqe shëndetësore bashkë me raportin mjekësor me nr. \*\* regj., lëshuar nga QSU-ja datë 20.12.2017 (me datë fillimi nga data 20.12.2017-23.12.2017). Në vendimin e gjykatës nr. \*\*\*, datë 21.12.2017 është shënuar se prezumohet se ka dijeni pala e paditur, shtetasi S. L, pa konsideruar se lidhur me këtë seancë ka pasur kërkesë për shtyrje. Nisur nga këto fakte të trajtuara në denoncim, Komisioni ftoi subjektin të paraqiste shpjegimet si anëtar trupe, duke u përqendruar kryesisht te pretendimi i denoncuesit mbi moszbatimin e dispozitës procedurale për shtyrje të seancës gjyqësore për shkaqe të arsyeshme.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim**

“Ky vendim gjykate është vendim i formës së prerë. Për efekt të vlerësimit të këtij vendimi duhet të mbahet parasysh vendimi nr. 29, datë 30.4.2001, i Gjykatës Kushtetuese. *Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se për sa kohë nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes.*”.

#### **Qëndrimi i Komisionit**

Trupi gjykues vlerëson se ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 21.12.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë nga ankuesi S.L është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë në datën 30.8.2018 dhe është ende në pritje të gjykimit, në kuptim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke qene objekt trajtimi i një gjykate më të lartë.

**171.7. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2018**, paraqitur nga shtetasja S.A, aktiviste e të drejtave të gruas pranë shoqatës “Në dobi të gruas shqiptare”. Ky denoncim i referohet subjektit të rivlerësimit, që sipas denoncueses është i korruptuar dhe ka kryer një sërë shkeljesh ligjore gjatë shqyrtimit të çështjes, që lidhet me një padi të ngritur nga shtetasja F. E-L, e pushuar nga puna për shkelje. Denoncuesja ka listuar shkeljet si: subjekti nuk ka pranuar palën e tretë në gjyq, duke shkelur kështu një nga të drejtat kushtetuese; ka trajtuar ankimin jashtë afatit (vendimi nr. \*\*\*, datë 2.2.2013, i Gjykatës së Rrethit Tiranë është ankimuar në maj të vitit 2013).

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2018, për sa i përket mospranimit të palës së tretë në proces gjyqësor si palë ndërgjyqëse dhe pretendimeve të tjera në këtë denoncim.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim**

Për këtë denoncim, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara lidhur me themelin e kësaj çështjeje në shkallë të parë dhe në apel, si dhe në përfundim ka cituar se *“kundër këtij vendimi nuk provohet që të jetë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se ankuesja ka qenë dakord me vendimin e apelit dhe është bindur për drejtësinë e vendimit të shkallës së parë”*. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vendimin e gjykatës.

#### **Qëndrimi i Komisionit**

Trupi gjykues, pas administrimit dhe vlerësimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur, arriti në konkluzionin se subjekti nuk ka kryer shkelje të dispozitave procedurale civile apo mosrespektim të të drejtave të palëve ndërgjyqëse.

**171.8 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2018**, paraqitur nga shtetasi M.D, drejtuar anëtarëve të një trupi gjykues të Gjykatës së Apelit, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi denoncon se në një çështje gjyqësore si përfaqësues i shoqërisë së tij “E-\*\*\*” sh.p.k., me palë të paditura dy shoqëri të tjera (“E.S.T” dhe “E.T.M.G”), Gjykata e Apelit nuk e ka thirrur (denoncuesi pretendon se ishte në ambientet e gjykatës 45 minuta përpara orarit të gjyqit), duke u zhvilluar procesi vetëm me palën tjetër ndërgjyqëse e duke sjellë për pasojë rrëzimin e padisë. Denoncuesi ka bashkëlidhur dokumentacion, nga administrimi i të cilit ka rezultuar se Gjykata e Apelit me vendimin nr.\*\*\*, datë 13.9.2016, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 16.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, subjekti ka pasur cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Referuar vendimit të gjykatës, është shkruar se denoncuesi ka qenë në mungesë, ndërsa ka qenë prezent pala e paditur e përfaqësuar me avokat.

Për sa më lart, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti rreth pretendimeve të paraqitura në denoncim, lidhur me mohimin e të drejtës së tij për t’u dëgjuar për shkak të mosthirrjes në seancë gjyqësore.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Lidhur me këtë denoncim, subjekti ka sqaruar se: “Së pari: me vendimin nr. \*\*, datë 13.9.2016, Gjykata e Apelit Tiranë, pasi shqyrtoi ankimin e shoqërisë ‘E-\*\*\*’, sh.p.k., me përfaqësues ligjor shtetasin M.D ka vendosur ‘lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*Akti, datë 16.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë’. Për njoftimin e ankuesit janë ndjekur të gjitha rregullat që parashikon ligjin me njoftimin me shpallje sikurse operon Gjykata e Apelit, për rrjedhojë, prezumohet dijenia për efekt të ligjit. Sipas Kodit të Procedurës Civile, vendimi i Gjykatës së Apelit është vendim i formës së prerë.

#### **Qëndrimi i Komisionit**

Trupi gjykues vlerëson se ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 13.9.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga ankuesi shoqëria “E -\*\*\*”, sh.p.k., është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë më 5.10.2016, e cila është regjistruar në datën 23.11.2016 dhe është ende në pritje të gjykimit. Trupi gjykues vlerëson se gjykimet mbi shkeljet procedurale vlerësohen bashkë me vendimin përfundimtar nga një gjykatë më e lartë.

**171.9 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2018**, paraqitur nga shtetasja R. Rr drejtuar disa subjekteve, ku referohet edhe subjekti i rivlerësimit. Komisioni administroi denoncimin dhe dokumentacionin bashkëlidhur dhe konstatoi se denoncimi nuk ka të dhëna lidhur me subjektin e rivlerësimit, prandaj nuk ka vend për trajtim.

**171.10 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2019**, paraqitur nga shtetasja R. Rr drejtuar ndaj disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesja, në këtë denoncim, është ankuar se në çështjen e saj gjyqësore nuk ka qenë dakord të shqyrtohet nga gjyqtarja V. H dhe për këtë i është drejtuar disa herë me kërkesa për përjashtim gjykatës, gjyqtarët e së cilës (përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit) nuk kanë pranuar, por kanë dhënë vendime të paramenduara dhe të qëllimshme. Komisioni i administroi faktet në këtë denoncim dhe

vlerëson se nuk ka kompetencë të vlerësojë mbi vendimet e marra, në rastin konkret, mbi vendimin e ndërmjetëm për përjashtim gjyqtari, i cili vlerësohet bashkë me vendimin përfundimtar nga një gjykatë më e lartë.

**171.11 Denoncimi i përsëritur me nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2019**, nga shtetasja R.Rr drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Ky denoncim lidhet dhe është vazhdim i fakteve trajtuar më lart në denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2019, në vijim të të cilit denoncuesi ka bashkëlidhur kallëzim penal të kryer ndaj subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të tjerë, të cilët nuk kanë marrë vendim për përjashtim të gjyqtarës V. H. Pas administrimit të fakteve, të paraqitura në denoncimet e shtetasës R.Rr, Komisioni vlerëson, sikurse më lart, për sa i përket mosdakordësisë së vendimeve të gjykatës, se janë objekt trajtimi i një gjykate më të lartë dhe se nuk ka objekt të trajtojë kallëzimin penal, që është atribut i organit procedues të prokurorisë.

**171.12 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2018**, paraqitur nga B.K.T drejtuar një trupi gjykues në Gjykatën e Apelit, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar. Në këtë denoncim trajtohen fakte të një procesi gjyqësor (në dy shkallët e gjyqësorit) me objekt pavlefshmërie të akteve të shitblerjes dhe shkëmbimit, ku B. K.T ka pasur cilësinë e personit të tretë në këtë proces gjyqësor, për shkak se pronat objekt pavlefshmërie kanë siguruar kredinë e marrë nga një palë gjyqësore. dhe trupi gjyqësor ka kryer shkelje të rënda të parimeve kushtetuese, të cilët kanë cenuar vendimin e marrë.

Ky trup nuk ka arsyetuar vendimin e dhënë, duke cenuar për pasojë, një nga parimet kryesore të drejtësisë atë të procesit të rregullt ligjor, nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me marrjen e disa provave të rëndësishme për procesin, si dhe ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, duke bazuar vendimin në pohime të njëjës palë, pa u bazuar në prova. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimin e Gjykatës së Apelit me nr. \*\*\*, datë 21.7.2016.

Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e anëtarit.

Nga leximi i këtij vendimi duket se nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm nga gjykata, për t'i dhënë zgjidhje të gjitha pretendimeve të palëve (sikurse ka cituar në këtë denoncim BKT-ja). Duket se kjo gjykatë ka bazuar vendimin në pohimet e palëve, pa kryer një hetim të plotë dhe të bazuar në akte shkresore për të krijuar bindjen se lidhja e kontratave ka qenë e simuluar (vetëm për qëllim të marrjes së kredisë në BKT) e, për rrjedhojë, të konstatohen të pavlefshme. Gjithashtu, duke u vlerësuar vendimi përfundimtar si një pasqyrë e qartë e të gjitha pretendimeve dhe veprimeve të kryera gjatë procesit gjyqësor me qëllim që t'i përcjellë palëve impaktin e vërtetë se janë dëgjuar dhe kërkesat e tyre janë vlerësuar, si një nga parimet kushtetuese të një procesi të rregullt ligjor, ky vendim nuk duket të jetë në standardin e një vendimi të arsyetuar. Lidhur me këtë denoncim, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me pretendimet e denoncuesit, si anëtar i trupit gjykues që ka shqyrtuar këtë çështje gjyqësore.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti ka sqaruar se kontrolli i vendimeve gjyqësore mbi interpretimin e ligjit material e procedural mund të bëhet vetëm nga një gjykatë më e lartë, si dhe për sa i përket cilësisë së arsyetimit të vendimit në rastin konkret.

#### **Qëndrimi i Komisionit**

Trupi gjykues vlerëson se ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 21.7.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga ankuesi BKT sh.a., është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 7.10.2016 dhe është ende në pritje të gjykimit, duke qenë objekt trajtimi i një gjykate më të lartë.

**171.13 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2018**, paraqitur nga shtetasi A. B, drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit, i cili së bashku me anëtarët e tjerë të trupit të Apelit kanë marrë vendim në dëm të tij për një objekt të ndërtuar pa leje. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimet e gjykatës në rreth

dhe apel që lidhen me këtë çështje. Komisioni, lidhur me këtë denoncim, vlerëson se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e vendimit përfundimtar nëse ka qenë i drejtë apo i gabuar.

**171.14 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2019**, paraqitur nga shtetasi T. Sh, drejtuar trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, ku subjekti ka qenë në cilësinë e kryesuesit. Ky denoncim ka në objekt trajtimin e vendimit të padrejtë të marrë nga trupi gjykues. Komisioni administroi denoncimin dhe vlerëson se nuk ka kompetencë të shprehet nëse vendimi i gjykatës ka qenë i drejtë apo i gabuar, kompetencë e cila i takon vetëm gjykatave më të larta.

**171.15 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2019**, paraqitur nga shtetasja Xh. J, drejtuar disa subjekteve, midis tyre edhe subjektit të rivlerësimit. Denoncuesja ankohet se ka pasur një shqetësim të madh, ndër vite, lidhur me pronën e saj, e cila i është shkatërruar për shkak të veprimeve të papërgjegjshme të fqinjëve të saj me depozitat e ujit. Denoncuesja ka cituar se e gjendur në kushte të vështira, invalide e pjesshme që jeton me të vëllanë e sëmurë, nuk ka arritur të gjejë drejtësi. Denoncuesja tregon se ka kallëzuar disa subjekte për shpërdorim detyre dhe ka ndjekur rrugët gjyqësore për zgjidhjen e problemit, si dhe ka theksuar se në Gjykatën e Apelit nuk është kryer hetim i plotë dhe vendimi nuk është bazuar në prova. Konkretisht, sipas saj, në vendimin nr. \*\*\* , datë 20.3.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\* , datë 17.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini, gjyqtarët kanë marrë për bazë deklarinimin e shtetasit (fqinjës) që ka shkatërruar pronën, se denoncuesja është e sëmure mendore dhe mashtruese, pa kryer të paktën një ekspertim mjekësor lidhur me shëndetin. Lidhur me këto fakte, denoncuesja ka bashkëlidhur dokumentacionin.

Komisioni administroi denoncimin dhe dokumentacionin e paraqitur nga denoncuesja, nga ku me vendimin nr. \*\*\* , datë 20.3.2019, trupi gjykues i Gjykatës së Apelit, në të cilin subjekti ka pasur cilësinë e anëtarit, ka vlerësuar të drejtë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini për pushimin e procedimit penal “shkatërrimi i pronës” me kallëzues denoncuesen dhe, në përfundim, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Komisioni ka verifikuar nëse ka pasur shkelje të ligjit në dhënien e këtij vendimi, në të cilin është analizuar me radhë çdo element i veprës penale, subjekti, ana subjektive, objekti, ana objektive, si dhe janë kryer edhe veprime verifikimi në vend, lidhur me pasojat e pretenduara nga kallëzuesja, ku në përfundim të analizimit ky trup ka arsyetuar se pse vendimi duhet lënë në fuqi.

Pas administrimit të vendimit, më lart-trajtuar, Komisioni vlerëson se nuk ka vend për *indicie* lidhur me kriterin profesional për subjektin e rivlerësimit.

**171.16 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2019**, paraqitur nga shtetasi A. Z drejtuar trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi denoncon gjyqtarët për procedurën e ndjekur në dhënien e këtij vendimi, pasi nuk është i bazuar në veprime ligjore dhe ka bashkëlidhur vendimin e gjykatës me nr. \*\*\* , datë 22.5.2019, me palë paditëse denoncuesin dhe palë të paditur dy shtetas të tjerë, përkatësisht, nëna dhe babai i denoncuesit me objekt detyrimin e të paditurve ta njohin bashkëpronar në një pasuri të paluajtshme, përfutur nga ligji “Për privatizimin”, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së privatizimit të pasurisë. Komisioni administroi faktet në denoncim dhe vendimin bashkëlidhur, ku subjekti ka pasur cilësinë e kryesuesit dhe mban qëndrimin se në këtë vendim janë pasqyruar dhe u janë dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në ankim nga denoncuesi, është kryer një analizim i plotë i ligjit që ka rregulluar marrëdhënien objekt konflikti dhe, në përfundim, është vendosur me vendimin përfundimtar. Komisioni, në përfundim të këtij denoncimi, vlerëson se pretendimet e themelit, lidhur me zgjidhjen e konfliktit, nuk janë objekt shqyrtimi nga ky institucion, prandaj nuk mund të trajtohen prej tij.

**171.17 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2017**, i shtetases L.P drejtuar disa subjekteve, ndërmjet të cilëve edhe subjektit të rivlerësimit si anëtar i një trupi gjykues në Gjykatën e Apelit. Denoncuesja i denoncon këto subjekte për korrupsion në dhënien e vendimeve. Komisioni



administroi denoncimin dhe dokumentacionin bashkëlidhur dhe nuk gjeti *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

**171.18 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2019**, paraqitur nga shtetasi V.Ç dhe **denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019**, i përsëritur i shtetasit V.Ç ndaj disa subjekteve, anëtarë në Gjykatën e Apelit, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit me objekt korrupsion e shpërdorim detyre. Komisioni administroi denoncimet së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur dhe nuk gjeti fakte të referuara për subjektin e rivlerësimit.

**171.19 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2019**, drejtuar ndaj një trupi gjykues në Gjykatën e Apelit, ku subjekti ka qenë anëtar, me objekt shkelje të një procesi të rregullt ligjor, shkelje të rënda të ligjit procedural civil dhe atij material në marrjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 6.11.2019. Denoncuesi ka bashkëlidhur vendimet e gjykatës mbi të cilat mbështet denoncimin dhe ndër shkeljet e përmendura, përveç atyre me karakter civil material, referon edhe shkeljet me karakter civil procedural si: Gjykata e Apelit nuk ka konsideruar shkeljet e kryera nga Gjykata e Shkallës së Parë lidhur me ndryshimin e objektit të padisë dhe shkakut ligjor, ndryshim i cili është kryer në heshtje, pa i paraqitur gjykatës kërkesë me shkrim për ndryshimin e shkakut ligjor të padisë; Gjykata e Apelit për shkak të mungesës së shkakut ligjor që e lidhte padinë duhej të vendoste prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit.

Komisioni i administroi vendimet e gjykatave të paraqitura nga denoncuesi dhe ndaloi në vlerësimin e vendimit të marrë nga Gjykata e Apelit (ku subjekti ka pasur cilësinë e anëtarit) në këndvështrim të shkeljeve të referuara nga denoncuesi. Komisioni nuk evidentoi në vendimin e relatuar *indicie* apo pretendime të palëve, që lidheshin me ndryshimin e shkakut ligjor gjatë shqyrtimit të padisë. Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit i ka dhënë sqarime pretendimeve të palëve ndërgjyqëse sipas ankimeve përkatëse. Komisioni, gjithashtu, evidenton se denoncuesi në cilësinë e palës ndërgjyqëse kishte të drejtën të paraqiste pretendimin në formën e ankimit para Gjykatës së Apelit, të cilin nuk e kishte paraqitur. Pretendimet e tjera të paraqitura nga denoncuesi si ato të natyrës së rregullimit të pasojave e të tjera të kësaj natyre, nuk janë në kompetencë të Komisionit, por të një gjykate më të lartë.

**171.20. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2018**, i shtetasit A. B ndaj një trupi gjykues në Gjykatën e Apelit, ku subjekti ka qenë anëtar trupi. Denoncuesi denoncon gjyqtarët për vendimet e marra ndaj tij, në kundërshtim me ligjin, se kanë favorizuar palën kundërshtare duke u bërë të njëanshëm në vendimin që kanë marrë lidhur me një konflikt civil midis denoncuesit dhe një shtetasi tjetër për lirim dorëzim sendi të paluajtshëm. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se me vendimin e dhënë nga këta gjyqtarë i kanë shkaktuar një dëm të madh, duke i mohuar të drejtat mbi pronën dhe fitimin e munguar. Denoncuesi ka bashkëlidhur aktet që janë administruar pranë gjykatave, si dhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë së bashku me rekursin e depozituar në gjykatën e lartë, por nuk ka depozituar vendimin e Gjykatës së Apelit, objekt referimi në këtë denoncim.

Referuar pretendimeve të denoncuesit më lart, Komisioni kërkoi shpjegimet e subjektit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar padia më palë paditës shtetasin A. B dhe i paditur shtetasi B. S, me objekt denoncimi “lirim dhe dorëzim sendi”. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.12.2014 vendosi pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim të dyja palët. Pasi shqyrtoi ankimin, vendimin nr. \*\*\*, datë 22.4.2016, Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur ndryshimin e vendimit civil nr. \*\*\*, datë 9.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Sipas Kodit të Procedurës Civile, vendimi i Gjykatës së Apelit është vendim i formës së prerë.

## **Qëndrimi i Komisionit**

Kontrolli i vendimeve gjyqësore mbi interpretimin e ligjit material e procedural mund të bëhet vetëm nga një gjykatë më e lartë.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Ridvan Hado, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ridvan Hado, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Transferimin e Gjetjes nr. 1 të vëzhguesit ndërkombëtar të monitorimit, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 3.1.2020, dhe Gjetjes nr. 2 të vëzhguesit ndërkombëtar të monitorimit, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, me përjashtim të pikës 2, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 24.6.2020.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
Kryesues

**Xhensila PINE**  
Relatore

**Brunilda BEKTESHI**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Emonda Hoxha*